



Sigma

Mbështetje për përmirësimin e Qeverisjes dhe të Menaxhimit
Një iniciativë e përbashkët e OECD dhe Bashkimit Europian, financuar kryesisht nga BE

**PROKURIMI PUBLIK NË SHTETET ANËTARE TË BE-SË:
RREGULLAT E KONTRATËS NËN KUFIJTË MONETARË TË BE-SË DHE NË ZONAT QË
NUK MBULOHEN NGA RREGULLAT E HOLLËSISHME TË DIREKTIVAVE TË BE-SË**

DOKUMENTI I SIGMA-S, NR. 45

MAJ 2010

Ky dokument është përgatitur me mbështetjen financiare të Bashkimit Europian. Pikëpamjet e paraqitura në të nuk përfaqësojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Europian dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e OECD-së dhe të vendeve anëtare të saj apo të vendeve përfituese, pjesëmarrëse në Programin SIGMA.

PROGRAMI SIGMA

Programi SIGMA - mbështetje për përmirësimin e qeverisjes dhe të menaxhimit - është një iniciativë e përbashkët e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD) dhe Bashkimit Europian (BE), financuar kryesisht nga BE.

Duke punuar në partneritet me vendet përfituese, Sigma mbështet qeverisjen e mirë përmes:

- vlerësimin të përparimit të reformave dhe identifikimit të përparësive bazuar në të dhëna bazë që pasqyrojnë praktikën e mirë europiane dhe legjislacionin ekzistues të BE-së (the *acquis communautaire*);
- dhënies së ndihmës për vendimmarrësit dhe administratat në ndërtimin e institucioneve dhe të procedurave për realizimin e standardeve dhe praktikën e mirë europiane;
- lehtësimin të ndihmës nga BE dhe donatorë të tjerë brenda dhe jashtë Europës duke ndihmuar për hartimin e projekteve, garantimin e parakushteve dhe mbështetjen për zbatimin.

Që në vitin 2008 Sigma po mbështet përpjekjet për reformimin e administratës publike në vendet partnere që vijojnë:

- **Vendet kandidatë të BE-së** - Kroacia, Ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Turqia
- **Vendet kandidatë potencialë për në BE nga vendet e Ballkanit Perëndimor** - Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova (sipas rezolutës 1244/99 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së)¹
- **Fqinjët dhe partnerët europianë (ENPI)** - Algjeria, Armenia, Azerbajxhani, Bjellorusia, Egjypti, Gjeorgjia, Izraeli, Jordania, Libani, Libia, Moldavia, Maroku, Territori i Pushtuar Palestinez, Siria Tunizia, Ukraina si dhe Rusia².

Programi SIGMA mbështet përpjekjet për reforma të vendeve partnere në fushat si më poshtë:

- **Kuadri ligjor, shërbimi publik dhe drejtësia:** kuadri ligjor dhe drejtësia, shërbimi public dhe kuadri administrative, integriteti public;
- **Menaxhimi i burimeve:** auditimi i jashtëm, menaxhimi i shpenzimeve publike, kontrolli i brendshëm financiar public (KBFP), prokurimi publik;
- **Politikat dhe sistemet rregullatore:** politikëbërja dhe koordinimi, politika rregullatore – normimi më i mirë, hartimi dhe zbatimi i reformave

Për më shumë informacion mbi Programin SIGMA, shihni faqen tonë të internetit:

<http://www.sigmaweb.org>

Të drejtat e autorit: OECD, 2010

Ky material është botuar për herë të parë në gjuhën angleze nën titullin: *Public Procurement in EU Member States: the Regulation of contract below the EU thresholds and in areas not covered by the detailed rules of the EU Directives.*

OECD autorizon përdorimin e këtij materiali pa pagesë, për qëllime jofitimprurëse. Të gjitha kërkesat për përdorim për qëllime fitimprurëse të këtij materiali ose për marrjen e të drejtave të përkthimit të materialit duhet të dërgohen në adresën elektronike rights@oecd.org.

¹ Në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, që në qershor të vitit 1999 Kosova qeveriset nga Misioni i Përkohshëm i Administrimit të OKB-së në Kosovë (UNMIK).

² Siç është rënë dakord me Komisionin Europian, aktivitetet e Sigma-s kryhen në fillim në nëntë vende prioritare: Egjypt, Jordani, Marok dhe Tunizi (ENPI-Jug); Armeni, Azerbajxhan, Gjeorgji, Moldavi dhe Ukrainë (ENPI-Lindje).

PARATHËNIE

Në të gjitha vendet anëtare të BE-së, përzgjedhja e kontratave të prokurimit publik, të cilat janë nën kufijtë monetarë të BE-së ka një rëndësi të konsiderueshme dhe përfaqëson një pjesë të madhe të prokurimeve në përgjithësi. Për rrjedhojë, hartimi në mënyrë efektive i politikave dhe rregullave kombëtare të prokurimit për akordimin e këtyre kontratave është thelbësor për të pasur një sistem të forte e efikas të prokurimit publik.

Direktivat Europiane 17 dhe 18, të vitit 2004, parashikojnë një grup procedurash bashkërenduese për kontratat publike mbi kufijtë monetarë të BE-së. Kjo paketë procedurash bashkërenduese, që shtetet anëtare duhet t'i përafrojnë në legjislacionin kombëtar, nuk mbulojnë të gjitha aspektet e procesit të prokurimit. Në kuadrin e *acquis*, çdo shtet anëtar mban përgjegjësi për organizimin e sistemit të vet të prokurimit, ligjërishit dhe institucionalisht, me qëllim sigurimin e përdorimit efektiv e efikas të burimeve publike.

Bazuar në punën e saj me shtetet e reja anëtare dhe vendet kandidate e ato të mundshme për kandidim, Sigma ka arritur në përfundimin se vendet janë përgjithësisht të pasigurta lidhur me mënyrën se si duhet të hartojnë kuadrin rregullator për tenderimin e kontratave jashtë fushës së zbatimit të Direktivave, duke sjellë si rezultat të mundshëm praktika e procedura joefikase. Për fat të keq, nuk është ndërmarrë ndonjë shqyrtim sistematik i mënyrës se si shtetet anëtare të BE-së kanë hartuar kuadret e tyre rregullatore jashtë fushës së veprimit të Direktivave të BE-së. Një vështrim krahasues, përfshi prezantimin e modeleve dhe instrumenteve kombëtare rregullatore të shteteve anëtare të BE-së do të ishte, për rrjedhojë, i dobishëm për vendet partnere të Sigma-s.

Studimi trajton procedurat dhe rregullat për tenderimin e kontratës nën kufijtë monetarë të BE-së dhe ofron, gjithashtu, një analizë të politikave dhe praktikave të zbatueshme për të gjitha kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së, të cilat kanë të njëjtën rëndësi për krijimin e një kuadri të plotë proceduror në nivel kombëtar. Fushat që nuk mbulohet posaçërisht nga Direktivat (të cilat trajtojnë parimet dhe detyrimet kryesore) përfshijnë, mes të tjerave, organizimin e procedurave të prokurimit, përgatitjen dhe përmbajtjen e dosjeve të tenderit, periudhat e vlefshmërisë së tenderit, dorëzimin e hapjen e ofertës, sigurimin e ofertës dhe zbatimit të kontratës, rregulla të hollësishme për transparencën e ofertave dhe pezullimin e anulimin e ofertave. Interes të posaçëm për zonat nën kufijtë monetarë të BE-së kanë instrumentet rregullatore, kufijtë monetarë kombëtarë, metodat e prokurimit, rregullat e shpalljes, rregullat e pjesëmarrjes, kriteret e përzgjedhjes dhe shpalljes së fituesit, specifikimet teknike dhe zgjidhjet e vlefshme ligjore.

Sigma beson se, bazuar në kuptimin e njohuritë e gjera të procedurave dhe praktikave ekzistuese jashtë fushës së veprimit të Direktivës së BE-së, që zbatohen në shtetet anëtare të BE-së, vendet e saj partnere do të jenë më shumë në gjendje për të projektuar kuadret të shëndosha ligjore jashtë fushës së veprimit të Direktivave të BE-së. Studimi ofron informacion mbi situatën e shteteve anëtare, pa u përpjekur të nxjerrë përfundime vlerore apo të nxjerrë rekomandime për modelet e preferuara procedurore.

Sigma dëshiron të falënderojë personat e kontaktit në shtetet anëtare për të gjithë mbështetjen e tyre të vlefshme në kryerjen e këtij studimi. Sigma është e bindur se informacionet e njohuritë e ofruara do të jenë shumë të dobishme për vendet e saj partnere. Vështrimi i ofruar nga ky studim mund të jetë interesant edhe për vetë shtetet anëtare, si edhe bashkësinë ndërkombëtare në përgjithësi.

PASQYRA E LËNDËS

PROGRAMI SIGMA	2
PARATHËNIE	3
PASQYRA E LËNDËS	4
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	5
Vëzhgime të përgjithshme	5
Vëzhgime të hollësishme	7
METODOLOGJIA	10
PJESA I. RREGULLAT DHE PROCEDURAT QË KANË TË BËJNË SPECIFIKISHT ME PROKURIMIN NËN KUFIRIN MONETAR TË BE-SË	11
Hyrje	11
1.1 Instrument(et) rregullatore ose udhëzimet për përzgjedhjen e kontratave fituese nën kufijtë monetarë të BE-së (Pyetja 1)	11
1.2 Kufijtë monetarë kombëtarë në zbatim, përveç kufijve monetarë të BE-së dhe procedurat e prokurimit nën kufijtë monetarë (Pyetjet 2 dhe 3)	13
1.3 Rregullat për ftesën për ofertë dhe shpalljen nën kufijtë monetarë të BE-së (Pyetjet 4 dhe 5)	14
1.4 Afatet për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave (Pyetja 6)	15
1.5 Mënyrat e dorëzimit të kërkesave dhe ofertave (Pyetja 7)	15
1.6 Politikat dhe rregullat për përzgjedhje cilësore (Pyetja 8)	16
1.7 Politikat dhe rregullat për vlerësimin e ofertave dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesit, përfshi rregullat për përcaktimin e ofertave me vlerë më të ulët se normalja (Pyetja 9)	16
1.8 Rregullat për specifikimet teknike (Pyetja 10)	17
1.9 Politikat dhe rregullat e prokurimit elektronik (Pyetja 11)	17
1.10 Politikat dhe rregullat për marrëveshjet kuadër (Pyetja 12)	17
1.11 Procedurat e vlefshme për ankesat, shqyrtimet dhe zgjidhjet ligjore (Pyetja 13)	18
PJESA II. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E PËRGJITHSHME TË PAPARASHIKUARA ME HOLLËSI NGA DIREKTIVAT E BE-SË	19
Hyrje	19
2.1 Organizimi i zhvillimit të tenderit (Pyetja 14)	19
2.2 Përzgjedhja dhe dokumentacioni i tenderit (Pyetja 15)	20
2.3 Rregullat për hapjen e ofertave (Pyetja 16)	21
2.4 Rregullat për sigurimin e ofertës dhe zbatimit të kontratës (Pyetja 17)	22
2.5 Rregullat për anulimin e zhvillimit të tenderit (Pyetja 18)	23
2.6 Rregullat për periudhën e vlefshmërisë së ofertave (Pyetja 19)	24
2.7 Përdorimi i sistemit me dy zarfe (Pyetja 20)	25
2.8 Rregullat lidhur me konfliktin e interesit (Pyetja 21)	25
2.9 Rregulla të posaçme për përzgjedhjen e konsulentëve dhe shërbimeve të tjera intelektuale (Pyetja 22)	26
2.10 Ndryshimet e planifikuara rregullatore (Pyetja 23)	26
SHTOJCA 1: TABELA PËRMBLEDHËSE	28
SHTOJCA 2: PYETËSORI	51

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Vëzhgime të përgjithshme

Përzgjedhja e fituesve të kontratave të prokurimit publik që janë nën kufirin monetar të BE-së ka rendësi domethënëse dhe përfaqëson pjesën më të madhe të totalit të prokurimeve në të gjitha shtetet anëtare të BE-së. Këto kontrata prokurohen përmes procedurave kombëtare që zbatohen për dhënien e kontratave nën kufijtë monetarë të BE-së. Numri i kontratave nën kufijtë monetarë të BE-së është më i madh se ato mbi këtë kufi. Prokurimi publik ka rendësi të posaçme për ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM). Për rrjedhojë, hartimi efektiv i politikave dhe rregullave të prokurimit për përzgjedhjen e këtyre kontratave fituese është thelbësor për ngritjen e një sistemi të forte dhe efikas prokurimesh. Legjislacioni i BE-së kërkon vetëm që parimet themelore të Traktateve të BE-së të respektohen në përzgjedhjen e kontratave fituese jashtë fushës së veprimit të Direktivave dhe ua lë shteteve anëtare hartimin e hollësishëm të rregullave e procedurave që gjejnë zbatim për këto kontrata. Sidoqoftë, studimi tregon se pjesa më e madhe e shteteve anëtare i rregullojnë prokurimet publike nën dhe mbi kufirin monetar të BE-së në të njëjtin akt dhe kërkojnë që kontratat nën kufirin monetar të BE-së të bazohen në procedura të hapura, të drejta dhe konkurruese. Këto procedura kanë në thelb tipare të ngjashme me ato që gjejnë zbatim në kuadrin e Direktivave të BE-së. Shtetet Anëtare që nuk kanë rregulla, nxisin ende përdorimin e tenderit konkurrues nën kufirin monetar të BE-së. Shkalla e thjeshtëzimit ndryshon mes shteteve anëtare, por objektivi thelbësor për sigurimin e një konkurrence të hapur respektohet në mënyrë të përhershme, edhe pse shtetet anëtare mund të marrin pozicione të ndryshme lidhur me kufirin e mosaplikimit të ligjit për prokurimin publik dhe me lejimin e blerjes së drejtpërdrejtë. Thjeshtimi përfshin si rregull shkurtimin e afateve për dorëzimin e aplikimeve dhe ofertave, si edhe kriteret për shpalljen dhe përzgjedhjen e ofertuesve. Në disa raste zbatohen rregulla më të buta, në funksion të zbatimit të procedurave me negociim dhe përdorimit të ftesës së drejtpërdrejtë për ofertë, por, në këtë rast, përfshihen edhe kërkesat për njoftim/shpallje paraprake ose kërkesa për ftesë e një numri minimal ofertuesish. Në të kundërt, rregullat e specifikimeve teknike, përzgjedhjes dhe kriterëve të shpalljes së fituesit, si edhe e drejta për ankesë janë në thelb të njëjta si për kontratat nën dhe mbi kufijtë monetarë të BE-së.

Pjesa e parë e studimit trajton konkretisht rregullat dhe procedurat që zbatohen për kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së. Pjesa e dytë shtjellon rregullat dhe procedurat që gjejnë zbatim për të gjitha kontratat (pavarësisht nga vlera e tyre), të cilat nuk përcaktohen me hollësi nga Direktivat e BE-së, por që janë njësoj të rëndësishme për krijimin e një kuadri të plotë proceduror në shkallë kombëtare. Këto fusha që nuk mbulohen specifikisht nga Direktivat përfshijnë, mes të tjerave, organizimin e procedurave për zhvillimin e prokurimit, përgatitjen dhe përmbajtjen e dosjeve të tenderit, periudhat e vlefshmërisë së tenderit, dorëzimin dhe hapjen e ofertave, sigurimin e ofertës dhe zbatimit të kontratës, rregullat e hollësishme për qartësimin e ofertave dhe pezullimi e anulimi i ofertave.

Studimi nuk mund të dalë me një përcaktim përfundimtar se në ç'shcallë ndryshojnë këto rregulla e procedura në varësi të madhësisë së kontratës, qoftë nën apo mbi kufijtë monetarë të BE-së, por ka tregues që, në fushat e studiuara, shtetet anëtare, për qëllime thjeshtimi, zbatojnë një regjim më të butë për kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së.

Fakti që një shtet anëtar nuk rregullon një fushë konkrete të mbuluar nga ky studim nuk nënkupton se praktika operative e kësaj procedure nuk është në fuqi apo se ajo nuk është subjekt rregullimi. Një shembull i mirë i kësaj që sapo thamë është çështja e konfliktit të interesit, e cila rregullohet nga akte të veçanta jashtë legjislacionit për prokurimin publik.

Në pjesën e dytë, studimi tregon se qasjet rregullatore të shteteve anëtare për këto politika e rregulla kanë ndryshime më të konsiderueshme sesa qasjet e tyre për kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së. Studimi nuk përpqet të shpjegojë **përse** një shtet anëtar merr një pozicion të caktuar, pasi kjo nuk hyn në objektin e këtij dokumenti, por ai mund të dalë në përfundimin se mes shteteve anëtare duket se ekzistojnë dallime në qasjet rregullatore. Këto dallime mund të shpjegohen me ndryshimet në politikat dhe traditat që qeverisin sistemet ligjore e administrative të shteteve anëtare, por mund të pasqyrojnë edhe pozicionin

rregullator në kohën e anëtarësimit në BE. Përgjithësisht, instrumentet rregullatore të anëtarëve të rinj të BE-së (2004 dhe 2007) përfshijnë, zakonisht, dispozita mjaft të hollësishme për organizimin dhe zhvillimin e procedurave të tenderit, të cilat duhet të ndiqen nga autoritetet kontraktuese gjatë procesit të prokurimit. Kjo përbën dallim me situatën në shtete të tjera anëtare, ku autoriteteve dhe enteve kontraktuese duket se u jepet më shumë kompetencë për organizimin e procedurave të tenderit.

Vëzhgime të hollësishme

Pjesa I. Rregullat dhe procedurat specifike për prokurimet nën kufijtë monetarë të BE-së

Studimi identifikon pikat vijuese si karakteristikat e tiparet kryesore të mënyrës sesi shtetet anëtare rregullojnë prokurimin publik nën kufijtë monetarë të BE-së:

- 1) Një pjesë mjaft e madhe e shteteve anëtare e rregullojnë prokurimin publik nën kufijtë monetarë të BE-së me ligj apo rregullore, të paktën në sektorin Klasik. Vetëm në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë, dokumentacioni orientues është mjeti i vetëm që udhëzon subjektet kontraktuese për detyrimet e tyre dhe praktikatat e mira në prokurimin nën kufijtë monetarë të BE-së.
- 2) Shumica e shteteve anëtare u referohen shprehimisht parimeve të Traktateve të BE-së në rregulloret e tyre.
- 3) Një numër i madh shtetesh anëtare përdorin të njëjtat rregulla për sektorët Klasikë dhe ato të Shërbimeve në rregullat e prokurimeve nën kufijtë monetarë të BE-së.
- 4) Megjithatë, një numër i konsiderueshëm shtetesh anëtare të analizuar nuk e rregullojnë aspak prokurimin në sektorin e Shërbimeve.
- 5) Ekzistojnë qasje të ndryshme për rregullimin e shërbimeve të Pjesës B: disa Shtete Anëtare zbatojnë rregulla që janë të ngjashme me ato që gjejnë zbatim për shërbimet e Pjesës A, ndërkohë që të tjera vende ofrojnë thjeshtime të mëtejshme ose vetëm iu referohen parimeve të Traktateve.
- 6) Shumica e shteteve anëtare që zbatojnë rregullore kanë dy ose edhe tre nënkufij poshtë kufijve monetarë të BE-së, të cilat, zakonisht, ndryshojnë sipas llojit të kontratës: më të ulëta për kontratat e furnizimit dhe shërbimit, më të larta për kontratat e punës. Fashat më të ulëta përcaktojnë nëse zbatohet apo jo rregullorja ose nëse lejohet prokurimi e drejtpërdrejtë. Fasha tjetër lejon përdorimin e procedurave të thjeshtuara, si për shembull, kërkesat për kuotim apo ftesat e drejtpërdrejta për ofertë; ky kufi monetar përcaktohet, si rregull, midis 50 000 dhe 70 000 eurot për kontratat e shërbimeve dhe furnizimit. Mbi këtë kufi monetar kombëtar, shume shtete anëtare zbatojnë pakashume të njëjtat rregulla dhe procedura si për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së, me përjashtim të rregullave kombëtare të shpalljes dhe shkurtimit të afateve për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave.
- 7) Prokurimi i drejtpërdrejtë lejohet, zakonisht, për kontrata me vlerë të ulët, të cilat kanë një kufi monetar nga 5 000 euro deri në 15 000 euro. Përveç varianteve të thjeshtuara të procedurave, parashikuar në Direktivat e BE-së (të hapura/të kufizuara/me negociim), shume shtete anëtare përcaktojnë përdorimin e procedurave konkurruese, bazuar në ftesat e drejtpërdrejta me njoftim paraprak (p.sh., kërkesë për ofertë ose kuotim). Shtete të tjera anëtare zbatojnë një regjim më të butë, përfshi mundësinë e negociimit me njoftim paraprak apo si pjesë e procedurave të hapura konkurruese.
- 8) Shumica e rregulloreve kërkojnë shpalljen e kontratave nën kufijtë monetarë të BE-së në faqet e internetit, buletinet e posaçme, bazat e të dhënave dhe faqet elektronike të enteve kontraktore. Kërkesat e shpalljes në publik vlejnë për njoftimet e kontratave dhe, në disa raste, edhe për njoftimin e përzgjedhjes së fituesit. Kur lejohet ndjekja e procedurave të thjeshtuara pa njoftim, rregullat parashikojnë që ftesa për ofertë të përfshijë një numër të mjaftueshëm operatorësh ekonomikë për të siguruar konkurrencën.
- 9) Shkurtimi i afateve për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave është një thjeshtim i zakonit që bëhet në shtetet anëtare. Disa prej këtyre shteteve nuk caktojnë ndonjë afat konkret dhe ua lënë atë në dorë subjekteve kontraktuese. Në rastin kur rregullat parashikojnë një afat minimal, çka ndodh zakonisht, ai shkon nga 10 deri në 15 ditë për paraqitjen e kërkesës dhe 10 deri në 25 ditë për dorëzimin e ofertave. Shpesh, këto afate mund të shkurtohen në rastin e paraqitjes në mënyrë elektronike.
- 10) Është interesante që në një numër fushash rregullat e procedurat janë pakashumë të ngjashme me ato që zbatohen për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së. Këtu përfshihen:

- mënyrat e dorëzimit të kërkesave dhe ofertave;
- kriteret e vlerësimit dhe për zgjedhjes së ofertës, përfshi edhe ofertat me vlerë më të ulët se kufiri i ulët;
- hartimi i specifikimeve teknike;
- marrëveshjet kuadër;
- prokurimi elektronik.

11) Shumica e shteteve anëtare me kuadër rregullator ndjekin për ankesat, shqyrtimet dhe zgjidhjet të njëjtat rregulla si për kontratat mbi kufirin monetar të BE-së.

Pjesa II. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme të paparashikuara me hollësi në Direktivat e BE-së

Tiparet kryesore të mënyrës sesi shtetet anëtare kanë rregulluar prokurimin publik në fushat që nuk trajtohen me hollësi në Direktivat e BE-së dhe që mund të gjejnë zbatim për të gjitha kontratat, qoftë nën apo mbi kufirin monetar të BE-së:

- 1) Një grup i madh shtetesh anëtare rregullojnë, pakashumë, me hollësi në aktin e prokurimit mënyrën e zhvillimit të procesit të tenderimit brenda autoriteteve kontraktuese. Zakonisht, kuadri rregullator përmban dispozita të hollësishme mbi përgjegjësitë, përbërjen dhe procedurat e punës të Komiteteve apo Komisioneve të krijuara në mënyrë të posaçme (KT). Përgjegjësitë e këtyre KT-ve përfshijnë zakonisht: (i) përgatitjen e dokumentacionit të tenderit dhe shpalljes së ftesave për ofertë, me mbështetjen e organizatës së linjës; (ii) administrimin e hapjes dhe vlerësimit të ofertave dhe (iii) nxjerrjen e rekomandimit, të detyrueshëm ose jo të detyrueshëm, të zgjedhjes së fituesit, për organin përgjegjës së organizatës së linjës.
- 2) Një grup i dytë i shteteve anëtare parashikon rregullime për organizimin e zhvillimit të tenderit në rregulloren e prokurimit ose përcakton atë në mënyrë mjaft të kufizuar. Përcaktimi i organizatës dhe procedurave të punës për veprimtaritë e prokurimit lihet, zakonisht, në autoritetin e subjekteve kontraktore. Akte të tjera administrative ose rregullore të brendshme mund të parashikojnë rregulla për organizimin e procesit të prokurimit. Sidoqoftë, kjo çështje shkon përtej objektit të këtij studimi.
- 3) Shumica e shteteve anëtare përcakton një informacion të hollësishëm mbi përmbajtjen e dokumentacionit të tenderit, që, shpesh, është i detyrueshëm, por nuk përfshijnë kërkesa për përdorimin e dokumenteve model ose standard për për zgjedhjen/kualifikimin dhe ftesat për ofertë. Ndonjëherë, ato lejojnë që subjektet kontraktore të vendosin një tarifë për dhënien e dokumenteve të tenderit. Sidoqoftë, duket se ky rregull zbatohet rrallë për ofrimin e dokumenteve në format elektronik. Një grup tjetër i shteteve anëtare nuk e trajton aspak këtë element, përtej asaj çka parashikohet nga Direktivat e BE-së.
- 4) Një pjesë e madhe e shteteve anëtare kërkon hapjen publike të ofertave pavarësisht nga madhësia e tyre, çka nënkupton se hapja publike gjen shpesh zbatim edhe për kontratat nën kufirin monetar të BE-së. Një tjetër grup i shteteve anëtare nuk ka vendosur rregulla për këtë fushë dhe ua lë autoriteteve kontraktuese vendimet për procedurat e hapjes së ofertave.

Shumica e shteteve anëtare parashikon dispozita **për sigurimin e ofertës dhe zbatimit të kontratës** për kontratat nën dhe mbi kufijtë monetarë të BE-së, por në pjesën më të madhe të vendeve, vendimet për zbatimin dhe masën e garancisë i lihen në kompetencë autoritetit kontraktor. Sidoqoftë, disa shtete anëtare nuk vendosin përdorimin e garancive financiare për kontrata nën kufijtë monetarë të BE-së. Një grup tjetër i shteteve anëtare nuk parashikon aspak dispozita rregullatore për garancitë financiare dhe rrallë i zbaton ato, edhe kur lejohen.

- 5) Shumica e shteteve anëtare parashikon rregulla për **anulimin** e procedurave të tenderit, por një numër prej tyre kanë vetëm rregulla të kufizuara ose asnjë rregull tjetër përveç atyre të parashikuara në Direktivat e BE-së.

- 6) Shumica domethënëse e shteteve anëtare e kanë të rregulluar në mënyrë pakashumë të hollësishme **afatin e vlefshmërisë së ofertës** që duhet të përfshihet në njoftimin e kontratës dhe dokumentacionin e tenderit. Disa shtete anëtare kanë parashikuar edhe numrin maksimal të ditëve të afatit të vlefshmërisë së ofertës, por pjesa më e madhe e vendeve lënë autoritetet kontraktore që të caktojnë afatin e vlefshmërisë. Së fundi, një grup i vogël shtetesh anëtare nuk kanë dispozita rregullatore për këtë pjesë.
- 7) **Sistemi me dy zarfe** përdoret vetëm në raste të rralla në shtetet anëtare, ashtu si dispozitat e posaçme mbi **prokurimin e shërbimeve të konsulencës**. Në shtetet anëtare, këto fusha janë të rregulluara, zakonisht, nëpërmjet procedurave standarde.
- 8) Shumë shtete anëtare kanë dispozita për **konfliktin e interesave** në kuadrin e tyre rregullator për prokurimet, veçanërisht ato të cilat kanë rregulluar organizimin e procedurave të tenderit. Disa shtete anëtare e kanë parashikuar çështjen e konfliktit të interesave në akte ose rregullore të tjera.
- 9) Vetëm pak shtete anëtare kanë tregues se mund të kryejnë ndonjë **ndryshim të mundshëm në kuadrin rregullator** në të ardhmen e afërt, përveç atyre të kërkuara nga legjislacioni eUropian.

METODOLOGJIA

Studimi u krye nga një Ekip i Projektit Sigma dhe u rishikua nga një Ekip Homolog. Të dhënat u mblodhën me anë të një pyetësi të hollësishëm që, në vitin 2009, iu dërgua pikave të kontaktit në 27 shtetet anëtare të Bashkimit Europian. Studimi pasqyron situatën e shteteve anëtare deri në korrik 2009. Të gjitha shteteve anëtare të trajtuara në këtë raport iu dha mundësia të komentonin mbi një kopje të raportit, në mënyrë që të verifikonin vlefshmërinë e informacionit.

Ekipi i Projektit u përbë nga Z. Peter Bennett, Z. Peder Blomberg, Z. Yves Allain dhe Z. Piotr-Nils Gorecki. **Ekipi Homolog** u ngrit për të bërë komente mbi metodologjinë, pyetësin dhe projektraportin e raportin përfundimtar. Ekipi u përbë nga Z. Michael Fruhmann (Austri), Z. Andrea Sundstrand (Suedi) dhe Z. Peter Trepte (Mbretëri e Bashkuar).

Pyetësi i hollësishëm i përgatitur nga Sigma iu dërgua organeve kombëtare përgjegjëse për rregullimin e prokurimit publik në shtetet anëtare, shoqëruar me një kërkesë për bashkëpunim dhe përgjigje për pyetjet. Për aq sa ishte e mundur, Ekipi i Projektit dhe Ekipi Homolog e analizuan materialin si bazë për përgatitjen e analizës krahasuese. Në periudhën korrik-dhjetor 2009, Sigmës iu kthye një numër i përgjithshëm prej 22 pyetësorësh nga Austria, Bullgaria, Qipro³, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Finlanda, Franca, Hungaria, Irlanda, Italia, Letonia, Lituania, Luksemburg, Holanda, Polonia, Rumania, Republika Sllovake, Sllovenia, Spanja, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar.

Është e nevojshme të bëjmë një koment lidhur me **kufijtë e qasjes metodologjike**. Jo të gjitha shtetet anëtare të BE-së e kthyen pyetësin. Për rrjedhojë, studimi nuk përbën një vështrim të plotë të kuadreve rregullatore në të gjitha shtetet anëtare aktuale. Sidoqoftë, kthimi i 22 nga 27 pyetësorët përfaqëson një përqindje pozitive reagimi, që mund të përdoret si bazë për një shqyrtim domethënës.

³

Shënim nga Turqia

Informacioni në këtë dokument që i referohet “Qipros” ka të bëjë me pjesën jugore të ishullit. Nuk ka një autoritet të vetëm që të përfaqësojë si popullin qipriot turk, ashtu edhe atë grek të ishullit. Turqia njeh Republikën Turke të Qipros Veriore (RTQV). Deri në gjetjen e një zgjidhjeje të qendrueshme e të barabartë në kontekstin e Kombeve të Bashkuara, Turqia ruan qëndrimin e saj lidhur me çështjen e Qipros.

Shënim nga të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Europian në OECD dhe Komisionin Europian

Republika e Qipros njihet nga të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara, me përjashtim të Turqisë. Informacioni në këtë dokument i referohet territorit nën kontrollin efektiv të qeverisë së Republikës së Qipros.

PJESA I. RREGULLAT DHE PROCEDURAT QË KANË TË BËJNË SPECIFIKISHT ME PROKURIMIN NËN KUFIRIN MONETAR TË BE-SË

Hyrje

Përzgjedhja e kontratave të prokurimeve publike që janë nën kufijtë monetarë të BE-së ka rendësi mjaft të madhe në të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit European.

Një vlerësim i Direktivave për Prokurimin Publik, i kryer nga Europe Economics për Komisionin European dhe i botuar në vitin 2006, doli në përfundimin se vetëm rreth 20% e masës së përgjithshme të prokurimit publik mbulohej nga rregullat e hollësishme të Direktivave, ndërsa pjesa tjetër trajtohej nga përjashtimet nga Direktivat, si disa prokurime për mbrojtjen dhe prokurimet nën kufirin monetar.

Sipas një Komunikatë Interpretuese (KI) të Komisionit European, këto kontrata përfaqësojnë mundësi domethënëse për bizneset në Tregun e Brendshëm, veçanërisht për NVM-të.

Rrjedhimisht, hartimi efektiv i politikave e rregullave kombëtare të prokurimit për akordimin e kontratave nën kufirin monetar është thelbësor për të pasur një sistem të forte dhe efikas të prokurimit publik.

Shtetet Anëtare kanë hartuar kuadrin e tyre të politikave, rregullave dhe procedurave nën kufirin monetar kundrejt sfondit të një numër vendimesh të dhëna nga Gjykata Ndërkombëtare e Drejtësisë (GjND). Këto vendime përcaktojnë se autoritetet dhe entet kontraktore që lidhin kontrata jashtë objektivit të Direktivave për Prokurimin Publik duhet të veprojnë në përputhje me parimet themelore të Traktatit të BE-së, në përgjithësi dhe parimin e mosdiskriminimit për shkak të kombësisë, në veçanti, kur kontratat kanë interes ndërkufitar. Në rastin Telaustria (rasti C-324/98), i cili ka të bëjë me koncesione shërbimi, GjND-ja komentoi lidhur me detyrimin për transparencë, që do të bënte të mundur që autoriteti ose enti kontraktor të sigurohej për përmbushjen e parimit të mosdiskriminimit, si vijon:

“Parimi i transparencës që i caktohet si detyrim autoritetit kontraktor ka të bëjë me sigurimin, në interes të çdo ofertuesi të mundshëm, e një shkalle reklamimi të mjaftueshme për të bërë të mundur hapjen e tregut të shërbimeve ndaj konkurrencës dhe rishikimin i paanshmërisë së procedurave të prokurimit”.

Në vitin 2006, në përgjigje të vendimeve si ai i çështjes Telaustria, Komisioni European hartoi një KI mbi të Drejtën Komunitare që zbatohet për përzgjedhjen e kontratave fituese, të cilat nuk janë pjesërisht ose tërësisht subjekt i dispozitave të Direktivave të Prokurimit Publik. KI-ja sqaron se parimet themelore të Traktatit janë të zbatueshme për të gjitha kontratat e prokurimit publik, duke iu referuar specifikisht kontratave për shërbimet e Pjesës B dhe kontratave nën kufirin monetar. Mesazhi kryesor i KI-së ishte se në përmbushjen e detyrimeve të Traktatit lidhja e kontratave specifike me tregun e brendshëm duhet të jetë faktori kryesor për përcaktimin e natyrës së shpalljes dhe procedurave të tjera që duhen ndjekur. Kjo u konfirmua më pas nga An Post (posta irlandeze) (C-507/03, 13 nëntor 2007).

Për informacion më të hollësishëm, shihni tabelën përmbledhëse në Shtojcën 1.

1.1 Instrument(et) rregullatore ose udhëzimet për përzgjedhjen e kontratave fituese nën kufijtë monetarë të BE-së (Pyetja 1)

Kjo pyetje kërkonte informacion lidhur me mënyrën si shtetet anëtare hartojnë një kuadër ligjor apo udhëzime se si duhet t'i përzgjidhen kontratat fituese nën kufijtë monetarë të BE-së nga autoritetet dhe entet kontraktore. Nga 22 shtete anëtare që iu përgjigjën kësaj pyetjeje, vetëm në Mbretërinë e Bashkuar dhe Irlandë udhëzimet janë mjetet e vetme për udhëzimin e blerësve rreth detyrimeve nën kufirin monetar.

Holanda ka rregullime dhe udhëzime vullnetare. Nga ana tjetër, shtetet anëtare ofrojnë një regjim nën kufirin monetar nëpërmjet rregulloreve që mbulojnë kriteret mbi kufirin monetar ose nëpërmjet rregulloreve kombëtare, apo një kombinim të të dyjave.

Direktivat për Prokurimin Publik (2004/18/KE dhe 2004/17/KE) parashikojnë se përzgjedhja e kontratave fituese është subjekt i parimeve të Traktatit dhe, veçanërisht, i parimeve të lirisë së qarkullimit të mallrave, lirisë së sipërmarrjes, lirisë për ofrimin e shërbimeve dhe parimet që rrjedhin prej tyre, si parimi i trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit, njohjes së ndërsjellë, proporcionalitetit dhe transparencës. Pjesa më e madhe e shteteve anëtare iu referohen shprehimisht apo në mënyrë të nënkuptuar në rregulloret e tyre detyrimeve të Traktatit të BE-së, me përjashtim të Hungarisë, Luksemburgut dhe Holandës. Republika Çeke i përfshin detyrimet e Traktatit vetëm për autoritetet kontraktore. Parimet të cilave shtetet anëtare iu referohen më së shumti në ligjet e tyre janë ato të trajtimit të barabartë, mosdiskriminimit dhe transparencës. Finlanda iu referohet këtyre tre parimeve, por i vendos ato në kontekstin e përmbushjes së nevojës për proporcionalitet nga ana e autoriteteve kontraktore.

Gjatë hartimit të rregullave të hollësishme për kontratat nën kufijtë monetarë, shtetet anëtare do të kenë marrë parasysh si donin të mbulonin kontratat nën kufirin monetar në sektorin Klasik, të Shërbimeve dhe për shërbimet e Pjesës B (*d.m.th.*, shërbimet që parashikohen nga rregullat e plota të Direktivave). Shumë shtete anëtare zbatojnë Rregulloret për kontratat mbi kufijtë monetarë për të rregulluar përzgjedhjen e kontratave fituese nën kufirin monetar në sektorin publik. Përveç kësaj, Bullgaria ka një rregullore për kontratat me vlerë të vogël, Urdhri për Kontratat e Vogla (OASPC). Rregullat daneze për kontratat nën kufirin monetar që mbulojnë punët (2005) dhe furnizimet e shërbimit (2007) janë të veçanta nga ligji në zbatim të Direktivave të BE-së. Holanda ka rregulla për sektorin e Shërbimeve dhe për punët në sektorin Klasik, të cilat autoritetet dhe entet kontraktore këshillohen t'i zbatojnë.

Tetë shtete anëtare që rregullojnë prokurimin nën kufirin monetar zbatojnë të njëjtën rregullore si për sektorin publik, ashtu edhe të Shërbimeve: Austria, Bullgaria, Franca, Hungaria, Italia, Lituania, Luksemburgu dhe Rumania. Sllovenia, Spanja dhe Suedia kanë rregulla nën kufirin monetar për Shërbimet në rregulloren e veçantë për Shërbimet. Tetë shtete anëtare, Republika Çeke, Qiproja, Danimarka, Estonia, Finlanda, Letonia, Polonia dhe Republika Sllovake nuk kanë rregulla të hollësishme nën kufirin monetar për Shërbimet. Këto kontrata rregullohen në një ose më shumë akte të veçanta. Edhe pse Danimarka nuk ka rregullore, entet kontraktore janë të detyruara të hartojnë rregulla të brendshme. Siç e kemi thënë tashmë, rregullat për sektorin e Shërbimeve në Holandë janë vullnetare.

Për shërbimet e Pjesës B, shtetet anëtare përdorin një sërë qasjesh dhe asnjë shtet anëtar nuk ka një ligj të posaçëm që trajton në veçanti shërbimet e Pjesës B. Hollësitë mbi procedurat nën kufirin monetar për shërbimet e Pjesës B duhet të shihen në kontekstin e asaj që është thënë më sipër, *d.m.th.*, që disa shtete anëtare parashikojnë vetëm rregulla nën kufirin monetar për sektorin Klasik dhe disa nuk i referohen shprehimisht detyrimeve të Traktatit në rregulloret e tyre. Italia ndjek qasjes mbi kufirin monetar parashikuar në Direktiva e BE-së, duke përcaktuar rregulla për specifikimet teknike dhe njoftimet për përzgjedhjen e kontratës fituese. Shërbimet e Pjesës B mund të akordohen nëpërmjet një procedure të negociuar pa njoftim paraprak, por duhet kërkuar kuotimi me një numër minimal prej pesë ofertuesish. Qasja e thjeshtuar nën kufirin monetar zbatohet edhe nga Austri, si pjesë e një regjimi mjaft të butë, nga Franca, ku duhet ndjekur një procedurë e përshtatshme, nga Polonia, e cila nuk aplikon shumë dispozita të hollësishme të legjislacionit të saj, nga Republika Çeke, e cila lejon përdorimin e procedurës së negociuar dhe nga Danimarka, e cila kërkon reklamimin të ndjekur nga negociim. Shtetet anëtare që ofrojnë një qasje më të strukturuar janë Suedia, ku kërkohet ose një procedurë e hapur e thjeshtuar ose një procedurë e thjeshtuar me dy faza, përfshi mundësinë e negociimit për secilën nga procedurat dhe Estonia, ku, për kontratat mbi kufirin monetar kombëtar, duhet zhvilluar një procedurë publike. Finlanda, Lituania dhe Sllovenia zbatojnë të njëjtat rregulla si mbi ashtu edhe nën kufirin monetar kombëtar, në rast se vlera e kontratës është mbi kufirin monetar kombëtar, edhe pse Finlanda lejon fleksibilitet sa i përket përdorimit të procedurës së negociuar. Qiproja kërkon zbatimin e rregullave mbi kufirin monetar për shërbimet e Pjesës B, pavarësisht nga vlera e kontratës.

1.2 Kufijtë monetarë kombëtarë në zbatim, përveç kufijve monetarë të BE-së dhe procedurat e prokurimit nën kufijtë monetarë (Pyetjet 2 dhe 3)

Në mënyrë që të përftojmë një tablo të plotë të detyrimeve që iu përcaktohen autoriteteve dhe enteve kontraktore, raporti merr në konsideratë përgjigjet që kanë të bëjnë me kufijtë monetarë dhe procedurat së bashku. Disa shtete anëtare kanë tri apo më shumë fasha në nivelin e kufijve monetarë të BE-së, ndërkohë që pjesa më e madhe e tyre kanë dy, me vetëm një kufi monetar kombëtar, nën të cilin bëhet prokurimi drejtpërdrejtë dhe mbi të rregullat nuk janë aq rigorozë sa në regjimin e plotë të BE-së. Qëllimi i kufijve monetarë dhe procedurave përkatëse mirëpërcaktohet nga Sllovenia me fjalët në vijim: “t’i formësojmë procedurat e përzgjedhjes së fituesit me lëndën e kontratës dhe, veçanërisht, me vlerën e përlllogaritur të kontratës, në bazë të parimit të proporcionalitetit”.

Pikëfillësa për kufirin kombëtar, nën të cilin mund të kryhet prokurimi i drejtpërdrejtë, ndryshon në mënyrë të konsiderueshme. Në Bullgari, Qipro, Finlandë, Francë, Letoni, Poloni, Rumani dhe Slloveni, kufiri është 15 000 euro ose më pak, ndërkohë që në Itali, Hungari, Lituani dhe Republikën Sllovaqe, ai shkon mes 20 000 dhe 30 000 eurove. Pika e fillimit në Austri është te 40 000 eurot, në Estoni 40 000 euro, në Luksemburg 55 000 euro, në Danimarkë 67 000 euro dhe në Republikën Çeke 70 000 euro.

Bullgaria, Qiproja, Rumania, Sllovenia dhe Republika Sllovaqe kanë tri ose më shumë fasha për prokurimin nën kufirin monetar, përfshi fashën e prokurimit të drejtpërdrejtë. Këto vende kanë një fashë ose disa fasha në të cilat zbatohen procedurat e thjeshtuara. Në vijim janë kufijtë monetarë për kontratat e shërbimeve dhe furnizimeve në sektorin Klasik. Në Qipro, procedurat e thjeshtuara zbatohen në dy nënfasha që shkojnë nga 1 700 euro në 8 500 euro dhe nga 8 500 euro në 85 000 euro (përafërsisht). Në nënfashën më të ulët kërkohen oferta me shkrim ose me gojë nga një numër i kufizuar ofruesish; në nënfashën më të lartë nuk kërkohet shpallja paraprake, por dokumentet e kontratave duhet t’iu dërgohen të paktën katër ofertuesve në përzgjedhur objektivisht. Nëpërmjet procedurës së thjeshtuar, Qiproja synon të përshpejtojë procesin dhe të ulë kostot e administrimit. Për një fashë midis 15 000 dhe 100 000 euro, Rumania kërkon zbatimin e kërkesave për kuotim (procedurë e thjeshtuar). Për një fashë mes 10 000 eurove dhe 40 000 eurove, ligji slloven kërkon marrjen e tri ofertave pa shpallje paraprake edhe autoritetet synojnë të kërkojnë shpallje paraprake edhe për këtë fashë të prokurimit. Sipas Urdhrit bullgar për Kontratat e Vogla (OASPC), duhet të kërkohen të paktën tri oferta për kontrata për furnizimet dhe shërbimet në një fashë mes 8 000 dhe 25 000 eurove. Rumani zbaton rregullat e BE-së mbi një kufi monetar prej 100 000 eurosh. Rregullat e BE-së mund të zbatohen edhe në Slloveni mbi kufirin monetar prej 40 000 eurosh, por për një fashë mes 40 000 eurove dhe 80 000 eurove autoritetet kontraktore mund të zbatojnë një procedurë të thjeshtuar, që nënkupton kërkimin e ofertave me njoftim paraprak të botuar në portalin kombëtar. Procedura e thjeshtuar mund të jetë me një ose dy faza, po është më pak e vështirë si për blerësit ashtu edhe për ofertuesit.

Letonia ka dy nënkufij monetarë nën të cilët lejohet blerja e drejtpërdrejtë: 4 500 euro (furnizime dhe shërbime) dhe 14 000 euro (punë). Mbi këto nënkufij monetarë e përkatësisht deri në 30 000 euro dhe 170 000 euro, mund të përdoret procedura konkurruese e thjeshtuar. Mbi këta nënkufij monetarë të dytë, zbatohen të njëjtat procedura dhe rregulla (me përjashtim të afateve më të shkurtra) si mbi kufijtë monetarë të BE-së. Prokurimi në sektorin e Shërbimeve është i parregulluar.

Austria ka nënkufij monetarë në nivelin e të cilëve zbatohen procedura të posaçme. Për furnizimet dhe shërbimet lejohet procedura e negociuar pa njoftim deri në 60 000 euro, ndërsa deri në 80 000 euro lejohet procedura e kufizuar pa njoftim dhe deri në kufijtë monetarë të BE-së lejohet procedura e negociuar me njoftim paraprak.

Disa shtetet anëtare kanë një kufi të vetëm monetar kombëtar për furnizimet dhe shërbimet. Disa prej këtyre vendeve kërkojnë zbatimin e rregullave të BE-së me thjeshtim të kufizuar poshtë këtyre kufijve monetarë, ndërkohë që të tjera nuk janë normativë lidhur me procedurat që duhen ndjekur. Vendet në vijim përdorin përgjithësisht procedurat e BE-së me variacione të kufizuara mbi kufijtë e deklaruar monetarë: Polonia (14 000 euro), Italia (20 000 euro, në rastet kur për punët dhe disa kontrata të tjera të parashikuara në ligj lejohet kërkesa për kuotim nga pesë ofrues) dhe Republika Çeke (70 000 euro).

Hungaria parashikon publikimin për kontratat mbi 27 000 euro dhe lejon negocimin nëse ai përcaktohet në njoftimin e kontratës. Lituania kërkon shpallje të detyruar për kontratat mbi 30 000 euro (për furnizimet dhe shërbimet) dhe 145 000 euro (për punët), por nuk ka një paketë procedurash që duhen ndjekur. Vetëm Hungaria ka kufi monetar (83 000 euro) për koncesionet e shërbimeve, Danimarka parashikon zbatimin e procedurave informale mbi një kufi monetar prej 67 000 eurosh. Në Suedi, kur prokurimi nuk është në vlerë të vogël (vlera e ulët nuk parashikohet nga një kufi monetar), kontratat duhet të shpallen dhe, më tej, vijon një procedurë e hapur e thjeshtuar ose një procedurë e thjeshtuar prej dy fazash. Në Spanjë, roli i kufirit monetar kombëtar është të tregojë nëse mund të përdoret një procedurë e negociuar dhe në Holandë rregullimet janë vullnetare. Në Francë, mbi kufirin monetar prej 90 000 eurosh, kërkohet botimi në Buletinin Zyrtar. Poshtë kufirit, autoritetet kontraktore janë të lira të zgjedhin një procedurë të përshtatshme mbi bazën e natyrës dhe karakteristikave të nevojave që duhen përmbushur dhe numrit a vendndodhjes së operatorëve ekonomikë që kanë të ngjarë t'i përmbushin këto nevoja. Shpallja dhe procedurat e konkurrencës duhet të jenë në përpjesëtim të drejtë me lëndën dhe vlerën e kontratës.

Kufiri minimal monetar për kontratat e punës në sektorin Klasik është, zakonisht, të paktën dy herë më i lartë sesa ai për kontratat e furnizimeve dhe shërbimeve. Kur ka më shumë sesa dy fasha, fashat që mbulojnë procedurat e thjeshtuara janë të një game më të gjerë. Për shembull, në Rumani, fasha në të cilën parashikohen kërkesat për ofertë shkon nga 15 000 euro në 750 000 euro për punët dhe nga 15 000 euro në 100 000 euro për furnizimet dhe shërbimet. Kjo është ajo çka mund të pritet, duke pasur parasysh se kufiri monetar i parashikuar nga Direktivat për kontratat e punës është 5 milionë. Vetëm Hungaria ka një kufi monetar të veçantë për koncesionet e punës (333 000 euro).

Danimarka, Italia dhe Luksemburgu zbatojnë qasje të ndryshme për procedurat e kontratave të punës dhe kontratave të furnizimeve dhe shërbimeve. Në Danimarkë, kërkohen procedura të hapura ose të kufizuara në bazë të rregullores për kontratat e punës mbi 40 000 euro. Në Itali, kërkesa për kuotim (minimalisht pesë) lejohet nën 200 000 euro, procedura e negociuar pa njoftim lejohet nën 500 000 euro dhe procedura e kufizuar e thjeshtuar lejohet nën 750 000 euro. Në Luksemburg, procedura e kufizuar lejohet për kontratat mbi 800 000 euro, nën të cilin lejohet vetëm procedura e hapur.

Siç është përmendur tashmë, një numër i kufizuar vendesh kanë një regjim nën kufirin monetar në sektorin e Shërbimeve. Bullgaria, Lituania, Luksemburgu dhe Rumania kanë të njëjtën qasje për procedurat dhe kufijtë monetarë si në sektorin publik. Për Rumaninë, fasha më e lartë arrin deri në 400 000 euro, duke pasqyruar kufirin e lartë monetar fillestar të Direktivës për Shërbimet. Italia ka të njëjtin kufi monetar si pikënisje. Në Austri, pika e nisjes është dyfishi i asaj të sektorit publik dhe në Hungari ky kufi fillestar është 167 000 euro përkundër 27 000 euro që është për sektorin publik. Është ndoshta e habitshme, duke pasur parasysh rregullat më elastike në sektorin e Shërbimeve, që nuk ka shumë dallim në regjimet nën kufirin monetar që janë miratuar nga këto shtete anëtare. Më tej, sërish, vetëm një numër i kufizuar vendesh kanë rregullore që përcaktojnë kërkesat nën kufirin monetar.

1.3 Rregullat për ftesën për ofertë dhe shpalljen nën kufijtë monetarë të BE-së (Pyetjet 4 dhe 5)

Disa shtete anëtare iu përgjigjën pyetjes 4 dhe 5 së bashku. Përgjithësisht, përgjigjet trajtojnë botimin e njoftimeve (pyetje 4) dhe përdorimin e formularëve standardë apo variacione të formularëve standardë (pyetje 5).

Njoftimet e kontratave botohen në botimet zyrtare (në letër) në Austri, Qipro, Itali, Lituani dhe Spanjë. Të gjitha këto vende, me përjashtim të Spanjës, i botojnë këto njoftime edhe në portalet apo faqet e tyre të internetit. Bullgaria, Republika Çeke, Finlanda, Hungaria, Letonia, Luksemburgu, Rumania dhe Republika Sllovaqe i botojnë njoftimet e tyre vetëm në portalet kombëtare në internet dhe/pse në formate elektronike. Në Rumani, në vitin 2008, rreth 66 000 e ftesave ishin botuar nga autoritetet/entet kontraktore në sistemin elektronik të prokurimit elektronik (ESPP). Në Poloni, autoriteteve kontraktore iu kërkohet, gjithashtu, të botojnë njoftimet në faqet e tyre të internetit për kontratat mbi dhe nën kufijtë monetarë kombëtarë.

Në Danimarkë, rregullorja përcakton kriteret për njoftime për kontratat e mallrave dhe shërbimeve, por nuk ka rregulla konkrete për publikimin, që bëhet ose në internet ose në gazeta. Në Francë, autoritetet/entet kontraktore, nën një kufi monetar prej 90 000 eurosh, mund të vendosin se si do e bëjnë botimin; mbi atë

kufi monetar, njoftimet duhet të botohen nga autoritetet publike në Buletinin Zyrtar (BOAMP) ose në gazetata që kanë të drejtë të botojnë njoftimet ligjore. Në Holandë, autoritetet kontraktore mund të vendosin se ku do t'i bëjnë këto botime dhe, zakonisht, ata përdorin faqen e tyre të internetit për këtë. Në Suedi kërkohet botimi në, të cilat janë falas.

Këto rregulla për Shërbimet janë të ngjashme në Austri, Bullgari, Qipro, Estoni, Lituani, Luksemburg dhe Suedi.

Disa vende (Qiproja, Republika Çeke, Estonia dhe Letonia) përdorin formularët standarde mbi kufirin monetar për kontratat nën kufirin monetar. Në Hungari, formularët standardë të njoftimeve përcaktohen me Urdhër të Ministrit të Drejtësisë, por janë mjaft të ngjashme me formularët standardë të BE-së. Luksemburgu përdor formularë të thjeshtuar standardë në portalin e tij (portali i Ministrisë së Punëve, ku botohen të gjitha njoftimet e saj). Rumania përdor, gjithashtu, një formular të thjeshtuar standard. Bullgaria përdor një formular standard të miratuar nga Ministria e Ekonomisë, Energjisë dhe Turizmit, që është i ngjashëm me formularët standardë të BE-së. Në Francë, formulari standard i kërkuar për procedurën e përshtatshme është në shtojcën bashkëlidhur një Urdhri Ministror të vitit 2006. Në Suedi, kërkohet vetëm botimi i njoftimeve të kontratave. Së bashku me njoftimet e kontratave, autoritet dhe entet kontraktore në Lituani kërkohet të bëjnë raporte pas procedurës së prokurimit publik në portalin qendror.

Këto rregulla për sektorin e Shërbimeve janë të ngjashme në Bullgari, Qipro, Estoni, Francë, Hungari, Lituani, Luksemburg, Rumani dhe Suedi.

Danimarka dhe Holanda kanë rregulla të kufizuara ose asnjë rregull për publikimin.

1.4 Afatet për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave (Pyetja 6)

Përgjithësisht, shtetet anëtare i shkurtojnë në mënyrë domethënëse afatet për kontratat nën kufirin monetar, krahasuar me kontratat mbi kufirin monetar. Për procedurat e hapura, afati më i zakonshëm për procesin është rreth 20 ditë, por ai shkon nga 14 deri në 30 ditë. Për procedurat e kufizuara (dhe të negociuara) afati më i zakonshëm i aplikimit është 10 ditë. Afati i zakonshëm për marrjen e ofertave në procedurën e kufizuar është rreth 15 ditë. Polonia ka afate të ndryshme për kontratat e punës: 20 ditë për procedurën e hapur krahasuar me 7 ditë për furnizimet e shërbimet dhe 14 ditë gjatë procedurës së kufizuar për marrjen e ofertave për kontratat e punës, krahasuar me 7 ditë për furnizimet dhe shërbimet. Letonia ka një kufi kohor prej 30 ditësh për dorëzimin e ofertave në procedurën e hapur dhe 25 ditë në procedurën e kufizuar. Poshtë fashës së parë afati shkurtohet në 15 ditë. Në Lituani, afati i dorëzimit të ofertave gjatë procedurës së hapur është përcaktuar për 7 ditë nga data e shpalljes. Disa vende i shkurtojnë këto afate për dorëzimin elektronik. Për shembull, në Rumani, afatet mund të shkurtohen nga 20 në 15 ditë gjatë procedurës së hapur dhe nga 15 në 10 ditë për marrjen e ofertave në procedurën e kufizuar.

Në Bullgari, afatet për kontratat nën kufirin e parashikuar nga Ligji për Prokurimin Publik ndjekin më së shumti ato të përcaktuara në Direktiva. Edhe Estonia zbaton të njëjtat afate me ato të kontratave mbi kufirin monetar si në sektorin publik, ashtu edhe në atë të Shërbimeve. Në Slloveni, autoritetet kontraktore mund të vendosin për afatet, duke marrë parasysh kompleksitetin e projektit. Ato mund të ndjekin edhe afatet e BE-së, edhe pse në praktikë afatet janë më të shkurtra dhe lejojnë parimin e proporcionalitetit. Në Francë, iu takon, përgjithësisht, autoriteteve kontraktore të vendosin, por afatet duhet të jenë të gjata aq sa të lejojnë sa më shumë operatorë ekonomikë që të jetë e mundur të paraqesin ofertën e tyre. Finlanda dhe Holanda nuk kanë rregulla lidhur me afatet.

1.5 Mënyrat e dorëzimit të kërkesave dhe ofertave (Pyetja 7)

Aty ku rregullat ekzistojnë, dorëzimi i kërkesave dhe ofertave mund të bëhet nëpërmjet postës, faksit ose rrugëve të tjera elektronike. Sidoqoftë, nevoja për pajisjen e duhur teknike dhe ofrimin e sigurisë dhe fshehtësisë janë të rëndësishme. Disa vende kanë rregullore të veçanta lidhur me transmetimin elektronik, siç është Ligji për Elektronikën dhe Nënshkrimin Elektronik në Bullgari. Në Republikën Çeke, për kërkesat elektronike kërkohen nënshkrime elektronike të autorizuara. Në Spanjë, dokumentacioni, përgjithësisht, dorëzohet në zarfe të mbyllur në adresën e caktuar ose, përndryshe, dërgohen me postë,

përveç rasteve kur dokumentet e tenderit autorizojnë procedura të tjera. Në Rumani, dorëzimi bëhet zakonisht në letër, por autoriteti/enti kontraktor mund të përmendë konkretisht rrugën elektronike. Letonia praktikon për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave të njëjtat rregulla me ato për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së.

Danimarka dhe Holanda nuk kanë dispozita konkrete ligjore dhe iu takon autoriteteve dhe enteve kontraktore që të vendosin mënyrat e dorëzimit. Franca aktualisht nuk ka dispozita ligjore, por autoritetet mund të kërkojnë dorëzimin në rrugë elektronike. Sidoqoftë, që prej 1 janarit 2010, dokumentet e kërkuara nga kandidatët duhet të dorëzohen në mënyrë elektronike për kontratat për pajisjet dhe shërbimet e teknologjisë së informacionit që i kalojnë 90 000 euro. Nga 1 janari 2012, autoritetet kontraktore nuk do të jenë në gjendje të refuzojnë dokumentet e dorëzuara elektronikisht për kontrata furnizimesh, shërbimesh ose punësh që i kalojnë 90 000 euro.

1.6 Politikat dhe rregullat për përzgjedhje cilësore (Pyetja 8)

Shtetet anëtare në vijim kanë, në thelb, të njëjtat rregulla për kontratat nën dhe mbi kufirin monetar: Austria, Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Danimarka, Estonia, Hungaria, Letonia, Lituania, Luksemburgu, Holanda, Polonia, Republika Sllovaqe dhe Suedia. Ndryshimi kryesor nga dispozitat e regjimit mbi kufirin monetar lidhet me dispozitën e provës së kriterëve të kualifikimit. Në Republikën Çeke, operatorët ekonomikë mund të ofrojnë provë për kriteret e kualifikimit nëpërmjet një deklaratë, në vend të dorëzimit të dokumenteve të përcaktuara. Në Poloni, autoritetet kontraktore nuk janë të detyruara të kërkojnë dokumente që konfirmojnë se operatorët ekonomikë përmbushin kushtet për pjesëmarrje. Sllovenia e thjeshtoi paraqitjen e provës, me qëllim shkurtimin e burokracive. Operatorët ekonomikë nuk janë të detyruar të ofrojnë asnjë provë lidhur me të dhëna që tashmë janë në dispozicion të autoriteteve publike. Iu takon autoriteteve kontraktore për t'i përfutuar këto të dhëna.

Në Finlandë, parimet e përdorura për hartimin e dispozitave nën kufirin monetar ndjekin ato të regjimit mbi kufirin monetar. Në Francë, ligji nuk ka dispozita konkrete, por nëpunësit e prokurimeve nuk lejohen të kërkojnë më shumë informacion sesa ai që kërkohet në rastin e kontratave mbi kufirin monetar. Në Itali, niveli i kriterëve ekonomike dhe teknike parashikohet nga aktet nënligjore. Në Rumani, autoritetet dhe entet kontraktore, në këndvështrimin praktik, duhet të përcaktojnë kriteret e kualifikimit. Ato mund të fusin një ose më shumë nga kriteret e zbatueshme mbi kufijtë monetarë ose të mos kërkojnë asgjë më tepër.

1.7 Politikat dhe rregullat për vlerësimin e ofertave dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesit, përfshi rregullat për përcaktimin e ofertave me vlerë më të ulët se normalja (Pyetja 9)

Përcaktimi i kriterëve për përzgjedhjen e fituesit në Direktivat e Prokurimit Publik bazohet ose në ofertën me përfitim më të madh ekonomik (MEAT) ose në çmimin më të ulët. Pjesa më e madhe e shteteve anëtare e ofrojnë një zgjedhje të tillë edhe nën kufirin monetar. Në vendet që e bëjnë një gjë të tillë përfshihet Austria, Bullgaria, Qiproja, Estonia, Finlanda, Hungaria, Italia, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania, Sllovenia, Republika Sllovaqe dhe Suedia. Në Suedi, vlerësimi i kriterit të ofertës me përfitim më të madh ekonomik nuk është i detyrueshëm; kriteri mund të vendoset në rend zbritës. Në Finlandë, qasja e kufirit të lartë monetar zbatohet masivisht edhe nën kufirin monetar, por objekti i kriterit të vlerësimit për disa kontrata shërbimesh ose punësh është më i gjerë sesa për kontratat mbi kufirin monetar. Ekspertiza, aftësia profesionale dhe kompetenca e personave përgjegjës për ofrimin e shërbimit apo ekzekutimit të punëve mund të përdoret si kriter përzgjedhjeje dhe si bazë e përmbushjes së kriterëve minimale për përzgjedhje. Franca nuk ka rregulla konkrete për procedurat e përshtatshme të zbatuara nga autoritetet dhe entet kontraktore nën kufirin monetar, por veprimet e zyrtarit të prokurimeve kufizohen nga legjislacioni.

Sa u përket ofertave me vlerë më të ulët se normalja, shumica e shteteve anëtare ose zbatojnë rregullat e Direktivave ose heqin çdo rregull të posaçëm. Në Luksemburg, nëse një ofertë është 15% poshtë çmimit mesatar, operatorit ekonomik i kërkohet të hartojë një analizë çmimi. Nëse kjo analizë nuk arrin të shpjegojë ofertën e ulët, ajo mund të hidhet poshtë. Italia ka një metodë matematikore për përcaktimin e ofertave më të ulëta sesa normalja. Më tej, në rastin kur paraqiten më shumë se 10 oferta, ato që janë më të ulëta se normalja mund të përjashtohen automatikisht nën kufirin monetar prej 1 milion eurosh për kontratat e punëve dhe nën 100 000 euro për kontratat e furnizimeve dhe shërbimeve.

1.8 Rregullat për specifikimet teknike (Pyetja 10)

Thujse të gjitha vendet kanë rregulla të njëjta për specifikimet teknike për kufirin e lartë dhe të ulët monetar. Në Estoni, Ministria e Financave ka vënë në dispozicion udhëzime shtesë. Në Suedi, rregullat për kufirin e lartë dhe të ulët monetar. Poshtë kufirit monetar, legjislacioni i tyre i referohet paragrafit 6 dhe 8 të Nenit 23 e Direktivës 18 të BE-së, e vitit 2004. Këto paragrafe u referohen specifikimeve që kanë të bëjnë me karakteristikat mjedisore dhe që nuk specifikojnë një markë apo burim të veçantë.

1.9 Politikat dhe rregullat e prokurimit elektronik (Pyetja 11)

Austria, Qiproja, Republika Çeke, Finlanda, Luksemburgu, Letonia, Rumania, Sllovenia, Republika Sllovaqe dhe Suedia kanë rregulla identike për prokurimin elektronik për kufirin e lartë dhe të ulët monetar.

Bullgaria parashikon zhvillimin e ankandëve elektronike dhe sistemeve të blerjes dinamike në Ligjin e saj për Prokurimin Publik. Përveç kësaj, Urdhri mbi Vlerën e Ulët (OASPC) përcakton se autoritetet dhe entet kontraktore mund të kryejnë ankande elektronike në konkurse projektimi kur specifikimet teknike janë të përkufizuara qartë. Në Estoni, të gjitha njoftimet regjistrohen në regjistrin elektronik qendror dhe ka plane në vazhdim për ngritjen e sistemeve të ankandëve elektronike dhe blerjes dinamike. Franca ka dispozita ligjore lidhur me procedurat e përshtatshme gjatë përdorimit të transmetimit elektronik, që duhet të marrë parasysh karakteristikat e kontratës (posaçërisht lënda dhe sasia e punëve, furnizimeve dhe shërbimeve) dhe të mos kufizojë konkurrencën. Zyrtarët e prokurimeve mund të kërkojnë dërgesa në rrugë elektronike dhe të refuzojnë ato përgjigje që nuk dërgohen elektronikisht. Kjo zbatohet për të gjitha procedurat që nga fillimi i vitit 2010. Rregullat e hollësishme mbi procedurat elektronike parashikohen në një Vendim të Qeverisë i cili plotëson rregullat e përgjithshme të përcaktuara në Aktin e Prokurimit Publik. Ligji lituanes për Prokurimin Publik i detyron autoritetet kontraktore të kryejnë të paktën 50% të prokurimit publik në rrugë elektronike. Polonia parashikon një alternativë për një procedurë të posaçme ankandi elektronik, por kjo gjen zbatime vetëm nën kufijtë monetarë të BE-së. Procedura nisët nga autoriteti kontraktor nëpërmjet shpalljes së njoftimit në faqen e saj elektronike dhe në faqen elektronike të Buletinit të Prokurimit Publik. Operatorët ekonomikë mund të përdorin, atëherë, një formular në internet për të dorëzuar ofertat vijuese më të favorshme.

Në vitin 2002, Italia miratoi një rregullore për prokurimin elektronik, që lejonte sektorin publik të kryente blerje nën kufirin monetar (me përjashtim të punëve) nëpërmjet platformës së prokurimit elektronik (MEPA), e krijuar nga Organi Qendror Italian i Blerjeve (CONSIP). Tregu është i hapur për furnitorët e kualifikuar, bazuar në kriteretë përzgjedhjeje që nuk janë kufizuese. Pas kualifikimit, katalogët e ofruesve ngarkohen në MEPA dhe shfaqen në një faqe të dedikuar interneti, e cila ia vendos ato në dispozicion gjithë komunitetit. Autoritetet kontraktore mund të shfletojnë katalogët, të krahasojnë produktet dhe çmimet, si dhe të kërkojnë kuotime apo të blejnë drejtpërdrejt nga katalogu elektronik. I tërë transaksioni është shifror dhe kërkon nënshkrim shifror.

1.10 Politikat dhe rregullat për marrëveshjet kuadër (Pyetja 12)

Shumica e shteteve anëtare zbatojnë të njëjtën qasje për përzgjedhjen e marrëveshjeve kuadër për kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe për ato mbi këta kufij. Këtu përfshihen Austria, Bullgaria, Qiproja, Estonia, Finlanda, Italia, Letonia, Luksemburgu, Polonia, Spanja, Rumania, Republika Sllovaqe dhe Suedia. Në Austri, marrëveshjet kuadër nën kufirin monetar për kontratat, deri në një kufi prej 350 000 eurosh, mund të lidhen përgjithësisht duke përdorur procedurën e negociuar me njoftim paraprak. Kjo qasje vlen vetëm për kontratat e punës deri në kufirin monetar të lartpërmendur. Në Slloveni, procedurat e thjeshtuara mund të përdoren në varësi të vlerave të kufijve monetarë. Në Hungari, autoriteti kontraktor ka kompetenca vendimmarrjeje mbi përzgjedhjen e marrëveshjeve kuadër. Franca, Danimarka dhe Lituania nuk ka dispozita të posaçme. Në Danimarkë, për kontratat nën kufijtë monetarë dhe për shërbimet e Pjesës B, zbatohen edhe procedurat e parashikuara nga Direktivat.

1.11 Procedurat e vlefshme për ankesat, shqyrtimet dhe zgjidhjet ligjore (Pyetja 13)

Në seksionin e tij për mbrojtje gjyqësore, Komunikata Interpretuese e Komisionit Europian për Legjislacionin Komunitar, që zbatohet në akordimin e kontratave, pa qenë aspak ose jo plotësisht subjekt i dispozitave të Direktivave të Prokurimit Publik, parashikon se zgjidhjet e vlefshme ligjore nuk duhet të jenë më pak efikase sesa ato që zbatohen për pretendime të ngjashme, të cilat bazohen në legjislacionin vendas (parimi i ekuivalencës) dhe nuk duhet ta bëjë të pamundur apo tejet të vështirë përfundimin e mbrojtjes gjyqësore (parimi i efektivitetit).

Vendet me rregulla poshtë kufirit monetar nuk shfaqin ndonjë dallim thelbësor në qasjen që ndjekin për zgjidhjet ligjore nën dhe mbi kufirin monetar. Sigurisht, sa më i hollësishëm regjimi nën kufijtë monetarë, aq më e lartë është mundësia për ankesa. Vendet në vijim kanë ndjekur të njëjtë qasje ndaj zgjidhjeve ligjore mbi dhe nën kufijtë monetarë: Austria, Bullgaria, Qiproja, Estonia, Hungaria Italia, Luksemburg, Letonia, Lituania, Spanja, Suedia dhe Sllovenia. Në Francë, politikat lidhur me zgjidhjet ligjore janë gjerësisht të ngjashme si mbi ashtu edhe nën kufirin monetar. Sidoqoftë, natyra ligjore (publike ose private) e autoritetit ose entit kontraktor përcakton se cila gjykatë do të trajtojë çështjet. Në Holandë, çështjet e shkeljeve mbi dhe nën kufirin monetar dërgohen në gjykatën civile, ku zbatohet një periudhë pushimi prej 15 ditësh (kjo ndodh në rrethanat kur aplikimi i ligjit nën kufirin monetar nuk është i detyrueshëm). Në Finlandë, qasja ndaj zgjidhjeve ligjore është më së shumti e njëjta si mbi ashtu edhe nën kufijtë monetarë, por moszbatimi i një periudhe pushimi nën kufirin monetar kufizon me gjasë numrin e ankesave.

Në Mbretërinë e Bashkuar (ku nuk ka rregullore nën kufirin monetar), mund të zbatohen procedura informale për trajtimin e problemeve lidhur me prokurimin mbi dhe nën kufirin monetar. Shërbimi i Reagimit të Furnitorit në Angli dhe Pika e Vetme e Kontaktit në Skoci janë dy procedura informale, që kanë për synim të ndihmojnë NVM-të.

PJESA II. RREGULLAT DHE PROCEDURAT E PËRGJITHSHME TË PAPANASHIKUARA ME HOLLËSI NGA DIREKTIVAT E BE-SË

Hyrje

Pjesa e dytë e studimit ofron një analizë të politikave e praktikave të zbatueshme për të gjitha kontratat, mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së. Këto politika dhe praktika janë po aq të rëndësishme sa rregullat e procedurat e diskutuara në pjesën I për ngritjen e një kuadri të plotë proceduror në shkallë kombëtare. Këto politika dhe praktika që nuk parashikohen në veçanti nga Direktivat përfshijë procedimet e prokurimit, përgatitjen dhe përmbajtjen e dosjeve të tenderit, afatet e vlefshmërisë së tenderit, dorëzimin dhe hapjen e ofertave, sigurimin e ofertës dhe zbatimin të kontratës, rregulla të hollësishme për sqarimin e ofertave, si edhe pezullimi e anulimi i ofertave.

Studimi nuk mund të përcaktojë përfundimisht se në ç'shikallë dallojnë këto rregulla e procedura sa i përket vlerës së kontratës, qoftë mbi apo nën kufijtë e BE-së, por ka tregues se, në funksion të thjeshtimit, shtetet anëtare ofrojnë një regjim më të butë nën kufijtë e BE-së në fushat e studimit.

Fakti se një shtet anëtar nuk ka rregulluar një fushë specifike që mbulohet nga ky studim, nuk nënkupton se praktika operative e kësaj procedure nuk është në fuqi. Një shembull është periudha e vlefshmërisë së tenderit, të cilën shumë shtete anëtare nuk parashikojnë në rregulla (shih më poshtë), por kur nevoja praktike për të përcaktuar një periudhë vlefshmërie në njoftimin e kontratës dhe dokumentacionin e tenderit e bëjnë këtë një kërkesë të detyrueshme. Po kështu, heqja e rregullave nga kuadri ligjor për prokurimet nuk nënkupton se fusha në vetvete nuk është subjekt i rregullimit. Një shembull i mirë i kësaj është çështja e konfliktit të interesave, që, shpesh, rregullohet nga akte të posaçme jashtë legjislacionit për prokurimin publik.

Me qëllim që të kuptojmë sa më mirë arsyen e pyetjeve të Pjesës II, çdo seksion nis me një shënim të shkurtër për sfondin. Këto shënime nuk duhet të konsiderohen si pasqyrim i këndvështrimeve të Programit Sigma, por si komente bazuar në përvojën e programit për mënyrën sesi janë hartuar kuadret rregullatore në vendet partnere në të shkuarën dhe në të tashmen.

2.1 Organizimi i zhvillimit të tenderit (Pyetja 14)

Sfondi

Direktivat nuk përmbajnë asnjë dispozitë konkrete për organizimin e zhvillimit të tenderit, me përjashtim të kërkesës që ofertat të hapen pas afatit të vendosur, me qëllim që të ruhet fshehtësia dhe, për tenderat elektronike, kërkesa për përdorimin e sistemeve dhe pajisjeve të vendosura gjerësisht në dispozicion. Përndryshe, hartimi i këtyre procedurave dhe praktikave, të cilat ndryshojnë më mënyrë të konsiderueshme, është tërësisht një problem kombëtar. Disa shtete anëtare përcaktojnë hapjen publike të ofertave; të tjera parashikojnë që ofertat të hapen nga një panel apo komision. Siç do të diskutohet, përdorimi i Komisioneve të Tenderit (KT) për hapjen dhe vlerësimin e ofertave është një praktikë e zakonshme në shumë shtete anëtare, veçanërisht mes anëtarëve të rinj, e parashikuar nga legjislacioni kombëtar. Sidoqoftë, ka dallime në funksionimin dhe mandatin që iu jepen këtyre komisioneve të tenderit.

Pozicioni rregullator në shtetet anëtare të BE-së

Studimi tregon se një numër i madh shtetesh anëtare i rregullojnë entet kontraktore nëpërmjet Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), ose mbi baza të përkohshme për tendera të veçantë, ose nëpërmjet më shumë komisioneve të përhershme. Bullgaria, Qiproja, Republika Çeke, Hungaria, Letonia, Lituania, Polonia, Rumania dhe Republika Sllovaqe i përkasin të gjitha këtij grupi vendesh. Në rastin e Polonisë, krijimi i KT-ve është i detyrueshëm mbi kufijtë monetarë të BE-së, ndërkohë që është vullnetar nën këta kufij. Ligjet e prokurimit në këto vende përmbajnë, përgjithësisht, dispozita mjaft të hollësishme për përgjegjësitë, përbërjen dhe procedurat e punës së KT-ve. KT-ja merret si me hapjen, ashtu edhe me vlerësimin e ofertave.

Një grup i dytë vendesh ofron një tablo më të kombinuar. Franca, për shembull, i detyron autoritetet vendore dhe rajonale të ngrene KT, por që prej dhjetorit të vitit 2008, i përjashton autoritetet shtetërore nga ky detyrim. LPP-ja italiane kërkon krijimin e KT-s kur zbatohet kriteri MEAT. LPP-ja sllovene nuk përcakton ngritjen e KT-së, por, në praktikë, entet kontraktore ngrenë KT. Kjo vlen edhe për Estoninë, ku krijimi i KT-ve nuk është i detyrueshëm në bazë të LPP-së, por është një praktikë e shpesh. Në Spanjë, entet kontraktore mund të ngrenë KT (organe kolegjiale). Austria kërkon vetëm krijimin e një komisioni për hapjen e ofertave.

Një grup i tretë vendesh karakterizohet nga mungesa tërësore e rregullave për organizimin e veprimtarive për prokurim. Vendimet lidhur me organizimin e procesit të tenderit iu lihen autoriteteve kontraktore. Ky proces mund të përfshijë krijimin e komisioneve apo grupeve të punës, por, rrallë, është me i zyrtarizuar. Këto komisione/grupe veprojnë vetëm për t'u ofruar mbështetje teknike apo tregtare organizatave të linjës. Austria (shih paragrafin e mëparshëm për përjashtimet), Danimarka, Finlanda, Holanda, Irlanda, Luksemburgu, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar janë pjesë e këtij grupi të tretë.

Ndërkohë që pjesa e parë e kësaj pyetjeje trajton çështjen e ngritjes së KT-ve, pjesa e dytë përpiket të përcaktojë pozicionin e vendimeve të pikës së kontraktor për prokurimet brenda entit kontraktor. Me fjalë të tjera, është KT-ja që merr vendime apo ajo lëshon rekomandime për vendimet që merren nga organizata e linjës?

Rregullat drejtuese të shteteve anëtare për këtë çështje janë të vështira për t'u përkufizuar, por duket se shumica e vendeve që kërkojnë ngritjen e KT-së, e kufizojnë mandatin e saj të lëshimit të rekomandimeve për vendime prokurimi, ndërkohë që vendimet zyrtare merren nga personi apo organi i autorizuar në autoritetin kontraktor.

2.2 Përzgjedhja dhe dokumentacioni i tenderit (Pyetja 15)

Sfondi

Direktivat përfshijnë rregulla të hollësishme për procesin e kualifikimit dhe përzgjedhjes, si edhe për përpunimin e specifikimeve teknike, por ato e lënë shtetin anëtar që, në thelb, të rregullojë përmbajtjen e hollësishme të dokumentacionit të procesit të zgjedhjes së ofertave dhe përzgjedhjes së fituesit. Kërkesat bazë që përcaktohen në Direktiva parashikojnë se ftesa për paraqitjen e një oferte, pjesëmarrjen në një dialog konkurrues apo për të negociuar duhet të përmbajnë të paktën:

Referencën për njoftimin e botuar të kontratës, afatin e dorëzimit të ofertave, adresën në të cilën duhet të dërgohen ofertat, gjuhën ose gjuhët në të cilat duhet të hartohen ofertat, referim për çdo dokument të mundshëm të bashkëlidhur për t'u dorëzuar, kopje të deklaratave të verifikueshme, informacion mbi përshtatshmërinë dhe aftësinë teknike dhe profesionale për procesin e kualifikimit dhe vlerësimin relativ të kriterëve për përzgjedhjen e kontratës fituese ose, kur është e nevojshme, rendin zbritës të kriterëve për nga rëndësia.

Disa vende kërkojnë gjithashtu, që entet kontraktore të përdorin modele të caktuara dokumentacioni për këto procese. Interesante është, gjithashtu, nëse ka rregulla sa u përket kostove, për sigurimin e dokumentacionit të tenderit.

Arsyeja themelore për ngritjen e këtyre pyetjeve është se dokumentacioni i tenderit luan një rol kryesor në procesin e tenderit. Dokumentet e tenderit duhet të ofrojnë të gjithë informacionin për një ofertues të mundshëm, të cilit i duhet të përgatitë një ofertë. Edhe pse hollësitë dhe kompleksiteti i dokumenteve mund të ndryshojë në varësi të vlerës dhe natyrës së kontratës, ato, përgjithësisht, përfshijnë:

- a) ftesën për ofertë;
- b) udhëzimet për ofertuesit;
- c) kushtet e përgjithshme dhe të posaçme të kontratës;
- d) termat e referencë/specifikimet teknike.

Pozicioni rregullator në shtetet anëtare të BE-së

Më poshtë jepen të përmbledhura disa tipare të përbashkëta:

- Asnjë shtet anëtar nuk përcakton përdorimin e një dokumenti për përzgjedhje të posaçme/parakualifikimi, por i referohet vetëm dokumentacionit që entet kontraktore duhet t'iu kërkojnë ofertuesve, në përputhje me rregullat e BE-së, nëpërmjet njoftimeve dhe/ose dokumentacionit të tenderit. Është normale që entet kontraktore të vendosin nëse do të nxjerrin një dokument të posaçëm përzgjedhjeje, por kjo duket se ndodh rrallë në praktikë.
- Shumica e instrumenteve rregullatore të shteteve anëtare përfshijnë, në shkallë të ndryshme përmbajtjen kryesore të dokumentacionit të tenderit, sa u përket kritereve të ftesës për ofertë, udhëzimet për ofertuesit, specifikimet dhe projektkontratat.
- Asnjë shtet anëtar nuk vendos detyrimin për përdorimin e një dokumentacioni model apo standard për tender, por disa vende i vendosin në dispozicion këto dokumente nëpërmjet udhëzimeve dhe dokumentacionit të praktikës së mirë.
- Shumica e shteteve anëtare lejon, si përjashtim, që entet kontraktore të vendosin tarifë për ofrimin e dokumentacioneve të tenderit, por kjo është vetëm për koston aktuale të riprodhimit dhe dhënies së dokumenteve të tenderit. Dërgesa elektronike po bëhet gradualisht më e shpeshtë, si metoda kryesore e dorëzimit të ofertave, duke eliminuar, me gjasë, çdo nevojë për vendosje tarife për dhënien e dokumenteve të tenderit.
- Danimarka, Finlanda, Irlanda, Holanda, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar i trajtojnë në mënyrë shumë të kufizuar ose aspak këto fusha në instrumentet e tyre rregullatore.
- Shtetet anëtare nuk bëjnë dallime midis rregullave për zgjedhjen dhe dokumentacionin e tenderit mbi bazën e vlerës së kontratës, qoftë mbi apo nën kufijtë monetarë të BE-së.

2.3 Rregullat për hapjen e ofertave (Pyetja 16)

Sfondi

Çfarëdo procedure të jetë parashikuar në rregulloret kombëtare, qëllimi i seancës së hapjes së ofertave është të kontrollohet që këto oferta janë të plota, që garancia e ofertës, aty ku kërkohet, është dhënë, që dokumentet janë nënshkruar në mënyrën e duhur dhe që ofertat janë, përgjithësisht, në rregull. Marrja e hapja e ofertave bëhet në mënyrë të tillë që të sigurohet rregullsia e procesit. Hapja është shpesh një proces i kryer nga KT-ja apo nga një panel prej të paktën dy personash të caktuar nga autoriteti kontraktor. Në një seancë publike të hapjes së ofertave njoftohet zakonisht sa vijon: emrat e ofertuesve, çmimet e pavarësuar të ofertave dhe paraqitja e garancive të kërkuara për ofertën, si edhe përmbushja e çdo formaliteti ose kushti që konsiderohet i përshtatshëm nga autoriteti kontraktor. Procesverbali i seancës së hapjes së ofertave përgatitet dhe, shpesh, iu shpërndahet ofertuesve pjesëmarrës. Marrja dhe hapja e ofertave shihet si një element i rëndësishëm i procesit të prokurimit, me qëllim garantimin e transparencës dhe trajtimit të barabartë.

Pozicioni rregullator në shtetet anëtare të BE-së

Shumica e shteteve anëtare i detyrojnë entet kontraktore (kërkesë e parashikuar në LPP) që t'i organizojnë publikisht hapjet e ofertave, me pjesëmarrjen e ofertuesve dhe/ose përfaqësuesve të tyre. Detyrimi për zhvillimin e seancës publike të tenderit zbatohet për të gjitha kontratat, pavarësisht nga vlera apo lloji i tyre. Ekzistojnë disa ndryshime lidhur me llojin e procedurës, si përjashtime për procedurën e negociuar me njoftim paraprak apo për kryerjen e prokurimit elektronik. Ky është rasti me Bullgarinë, Republikën Çeke, Estoninë, Hungarinë, Italinë, Lituaninë, Luksemburgun, Poloninë, Rumaninë dhe Republikën Sllovaqe.

Një grup i dytë i shteteve anëtare përfshin dispozita për hapjen e ofertave në instrumentin rregullator. Këto dispozita mund të përcaktojnë hapjen publike, por mund të vendosin kufizime të caktuara apo të parashikohen si kërkesa jo të detyrueshme. Në LPP-në austriake, hapja është rregull i përgjithshëm, por në

disa raste të justifikuara, enti kontraktor mund të zhvillojë një seancë me dyer të mbyllura. Në Qipro, hapja publike mund të zhvillohet në bazë të vendimit të enteve kontraktore. Në Danimarkë, hapja publike e ofertave për kontratat e punëve është e detyrueshme, por në të gjitha rastet e tjera zhvillohen seanca me dyer të mbyllura. Në Slloveni, hapja publike e ofertave është e detyrueshme mbi kufijtë monetarë kombëtarë, por kontratat me vlerë të ulët përbëjnë përjashtim. Spanja, gjithashtu, i përket këtij grupi deri në një farë shkalle, duke qenë se hapja e ofertave në publik duhet të kryhet kur zhvillohet një procedurë e hapur, por, kur përdoret kriteri MEAT, zbatohen rregulla të veçanta kufizuese.

Një grup i tretë përbëhet nga vende ku ky proces ose është krejtësisht i parregulluar, vullnetar, ose nuk lejohet. Në Finlandë, vendimi për hapjen ose jo në publik të ofertave është çështje që i takon tërësisht enteve kontraktore. Në Francë nuk lejohet hapja e ofertave në publik. Në Finlandë, autoriteti kontraktor vendos nëse ofertat do të hapen publikisht, por, praktika e përgjithshme është zhvillimi i seancave me dyer të mbyllura. Irlanda dhe Mbretëria e Bashkuar nuk e rregullojnë një çështje të tillë, por zhvillimi i seancave me dyer të mbyllura është procedura e preferuar.

Shkalla në të cilën procedurat për hapjen e ofertave do të ndikohen nga futja e prokurimit elektronik dhe përzgjedhja e marrëveshjeve kuadër është e vështirë për t'u vlerësuar.

2.4 Rregullat për sigurimin e ofertës dhe zbatimit të kontratës (Pyetja 17)

Sfondi

Sigma ka konstatuar se përfshirja e dispozitave për sigurimin e ofertës dhe zbatimit të kontratës në LPP ka qenë dhe vazhdon të jetë praktikë e zakonit në shumë prej vendeve të saj partnere. Kjo praktikë mund të gjendet fillimisht në Ligjin Model të UNCITRAL-it dhe financimi për prokurime nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (p.sh., Banka Botërore dhe BERZh-i). Vendimi për zbatimin e sigurimit të ofertës dhe zbatimit të kontratës iu lihet enteve kontraktore, por ekzistojnë edhe shembuj të rregullave që e bëjnë këtë të detyrueshme.

Në rastin kur është e nevojshme, ofertuesi duhet të paraqesë sigurimin e ofertës si pjesë përbërëse e dorëzimit të saj dhe duhet t'i ofrojë autoritetit kontraktor mbrojtje të arsyeshme kundrejt ofertave të papërgjegjshme.

Shuma e sigurimit përcaktohet në dokumentet e tenderit dhe, normalisht, shkon nga 1-5% të çmimit të ofertës. Sigurimi i ofertës mund të konfiskohet kur:

- a) ofertuesi tërheq ofertën gjatë periudhës së vlefshmërisë së tenderit;
- b) ofertuesi fitues nuk nënshkruan kontratën, nuk ofron sigurimin e zbatimit të kontratës ose nuk pranon korrigjimin e çmimit të ofertës së tij.

Sigurimi i zbatimit të kontratës (zakonisht, 5-10% e çmimit të kontratës) garanton zbatimin e duhur të kontratës dhe dorëzohet nga ofertuesi fitues si kusht për lidhjen e kontratës. Të ardhurat nga sigurimi i kontratës i paguhen blerësit si dëmshpërblim për çdo humbje që vjen si pasojë e mospërmbushjes së detyrimeve të kontratës nga ofruesi.

Pozicioni rregullator në shtetet anëtare të BE-së

Shumica e shteteve anëtare të BE-së përfshijnë dispozita për sigurimin e ofertës dhe/se zbatimit të kontratës në një formë apo tjetër, por me ndryshime në zbatimin e tyre. Vetëm Danimarka, Finlanda, Franca, Irlanda, Luksemburgu, Holanda, Sllovenia, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar nuk përfshijnë dispozita specifike për garancinë.

Në pjesën më të madhe të vendeve ku zbatohet sigurimi i ofertës dhe/ose i zbatimit të kontratës, vendimi për zbatimin e tij dhe përcaktimin shumës i lihet në kompetencë autoritetit kontraktor. Sidoqoftë, disa vende përcaktojnë rregulla më të hollësishme për zbatimin e tyre. Për shembull, në Poloni, entet kontraktore duhet të kërkojnë sigurimin e ofertës për të gjitha kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së dhe

mund ta bëjnë këtë për kontratat poshtë këtyre kufijve. Në disa vende (p.sh., Republika Çeke dhe Lituania), entet kontraktore mund t'i aplikojnë garancitë mbi kufijtë monetarë të BE-së, por jo poshtë tyre. Në Lituani, kërkesa për sigurimin e zbatimit të kontratës është e detyrueshme mbi kufijtë monetarë të BE-së. Interesant është fakti se në Itali është e detyrueshme të kërkohej sigurimi për të gjitha kontratat, me përjashtim të shërbimeve inxhinierike.

Ashtu siç është përmendur, zbatimi i sigurimit të ofertës dhe zbatimit të kontratës praktikohet në një shumicë vendesh si për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe për ato poshtë këtyre kufijve. Zbatimi i tyre përcaktohet si i detyrueshëm apo fakultativ nga LPP-të. Kur është e zbatueshme, duket se pjesa më e madhe e LPP-ve ua lë këtë vendim për zbatimin ose jo të sigurimit të ofertës dhe zbatimit të kontratës enteve kontraktore.

2.5 Rregullat për anulimin e zhvillimit të tenderit (Pyetja 18)

Sfondi

Sipas Direktivës 18 të BE-së, e vitit 2004 (Neni 41), në rastin e anulimit të një procedure të përzgjedhjes së kontratës, “të gjithë ofertuesit duhet të njoftohen sa më shpejt të jetë e mundur, me konfirmim me shkrim, kur kërkohej, së bashku me arsyet e anulimit. Më tej, entet kontraktore duhet të botojnë në Fletoren Zyrtare informacionin për ndërprerjen e procedurës së tenderit në një njoftim të posaçëm për informacion shtesë, informacion mbi procedurën e paplotë ose korrigjim”.

Në bazë të rregullave kombëtare, entet kontraktore, përpara nënshkrimit të kontratës, mund të braktisin prokurimin apo të anulojnë procedurën e tenderimit, ndërkohë që kandidatët apo ofertuesit nuk kanë asnjë të drejtë të pretendojnë kompensim.

Anulimi, në bazë të rregullave kombëtare, mund të ndodhë në rastet kur:

- a) procedura e tenderit nuk ka qenë e suksesshme; kur nuk është paraqitur asnjë ofertë apo asnjë ofertë e përshtatshme;
- b) të dhënat ekonomike ose teknike lidhur me tenderin janë ndryshuar në mënyrë thelbësore;
- c) rrethana të jashtëzakonshme apo një forcë madhore e bën të pamundur zbatimin normal të kontratës;
- d) të gjitha ofertat që përmbushin kushtet teknike tejkalojnë burimet financiare në dispozicion;
- e) ka pasur parregullsi në procedurë, veçanërisht, në rastet kur ato kanë penguar konkurrencën e ndershme.

Është e rëndësishme të përmendim se rregullat për anulim parashikohen, shpesh, në njoftimin e kontratës apo dokumentet e tenderit.

Pozicioni rregullator i shteteve anëtare të BE-së

Pjesa më e madhe e shteteve anëtare kanë rregulla lidhur me anulimin e procedurave të tenderit në mënyrë pakashumë të hollësishme. Vende të tjera nuk kanë asnjë rregull për anulimin e procedurave të tenderit, përveç dispozitave detyruese të Direktivave. Shtetet anëtare të cilat kanë rregulla të hollësishme përfshijnë Austrinë, Bullgarinë, Qipron, Republikën Çeke, Hungarinë, Poloninë dhe Rumaninë. Legjislacioni i tyre ofron informacion të hollësishëm lidhur me arsyet e anulimit (qoftë i detyrueshëm ose jo i detyrueshëm), dhe specifikon procedurat që duhet të zbatohen. Arsyet për anulim në këto vende pasqyrojnë listën e praktikave të përgjithshme të paraqitura më lart. Austria, madje, praktikon edhe një periudhë pushimi prej 14 ditësh për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së dhe 7 ditë për kontratat poshtë këtij kufiri, përpara sesa vendimi i anulimit të hyjë në fuqi. Në Lituani, vendimi për anulim kërkon miratimin paraprak të Zyrës së Prokurimit Publik për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së.

Një grup i dytë i shteteve anëtare ka rregulla më pak të hollësishme anulimi dhe, ndonjëherë, përdor instrumente rregullatore të ndryshme nga ligji i prokurimeve. Estonia, Italia, Finlanda (kuadri ligjor),

Luksemburgu (urdhër qeveritar), Sllovenia dhe Spanja i përkasin këtij grupi. Në Slloveni, enti kontraktor ka të drejtë të anulohet zhvillimin e tenderit për shkak të rrethanave të pavolitshme, për aq kohë sa kriteret e njoftimit respektohen plotësisht. Në Spanjë, enteve kontraktore iu kërkohet t'u paguajnë kompensim ofertuesve, në rastin e anulimit të procedurës së tenderit.

Së fundi, një grup i tretë vendesh nuk kanë asnjë rregull, përveç atyre të vendosura nga Direktivat e BE-së. Danimarka, Franca, Irlanda, Suedia dhe Mbretëria e Bashkuar i përkasin këtij grupi.

2.6 Rregullat për periudhën e vlefshmërisë së ofertave (Pyetja 19)

Sfondi

Si rregull, periudha e vlefshmërisë së ofertave duhet të specifikohet në ftesën për ofertë nëpërmjet përfshirjes së informacionit në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Kjo periudhë duhet të jetë, gjithashtu, e mjaftueshme për të bërë të mundur që autoriteti kontraktor të përfundojë vlerësimin e ofertave dhe të lidhë kontratën me ofertuesin fitues. Në raste përjashtimore, enti kontraktor mund t'i u kërkohet ofertuesve zgjatjen me një numër të caktuar ditësh të periudhës, përpara skadimit të vlefshmërisë.

Në vijim, entet kontraktore janë të detyruara pavarësisht nëse periudha e vlefshmërisë së tenderit është e rregulluar ose jo nga aktet ligjore dhe nënligjore për prokurimet, për të specifikuar konkretisht periudhën e vlefshmërisë së tenderave në shpalljen për konkurs, në njoftimin e kontratës, nëse përdoret një i tillë për ftesën për ofertë ose në dosjet e tenderit, në rastin e një ftese të drejtpërdrejtë për ofertë. Periudha e vlefshmërisë, në të gjitha rastet duhet të përcaktohet shprehimisht në dosjen e tenderit.

pozicioni rregullator në shtetet anëtare të BE-së

Mund të identifikohen modelet vijuese:

- a) Një grup vendesh kanë përfshirë në legjislacionin e tyre të prokurimeve rregulla mjaft të hollësishme për periudhën e vlefshmërisë së tenderit, përfshi numrin e ditëve që zbatohet në rrethana të ndryshme. Austria, Qiproja, Luksemburgu, Polonia dhe Spanja i përkasin këtij grupi. Në Austri, periudha e vlefshmërisë në rastet normale kufizohet në një afat maksimal prej 5 muajsh dhe, në raste të veçanta, deri në shtatë muaj. Nëse nuk ka një periudhë vlefshmërie të përcaktuar konkretisht, zbatohet periudha njëmuajore. Periudha maksimale në Qipro është 6 muaj. Në Luksemburg, periudha normale është 2 muaj dhe mund të shtyhet deri në 4 muaj. Kur lind nevoja për një shtyrje më të gjatë sesa 4 muaj, kërkohet miratimi i ofertuesve. Në Poloni, periudha e vlefshmërisë për kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së është 30 ditë. Mbi kufijtë monetarë të BE-së, periudha normale është deri në 60 ditë. Për kontratat me vlerë të lartë, periudha zgjat deri në 90 ditë. Në Spanjë, periudha e vlefshmërisë së tenderit përcaktohet nga kriteri i përzgjedhjes që përdoret. Përzgjedhja duhet bërë brenda 15 ditëve nëse zbatohet kriteri i çmimit më të ulët dhe brenda 30 ditëve kur përdoret kriteri MEAT (përveçse kur është përcaktuar një tjetër afat në ftesën për ofertë).
- b) Një grup i dytë vendesh i ka të përcaktuara, gjithashtu, rregullat për periudhën e vlefshmërisë së tenderit, por, në ndryshim nga grupi i parë, entet kontraktore mund të vendosin vetë për përcaktimin e periudhës së vlefshmërisë. Ky grup, më i madhi, përfshin Bullgarinë, Republikën Çeke, Estoninë, Francën, Hungarinë, Italinë, Lituaninë, Rumaninë dhe Republikën Sllovaqe. Rumania ka, gjithashtu, udhëzime që rekomandojnë një periudhë vlefshmërie për tenderin prej 90-120 ditësh. Në Itali, në qoftë se ftesa për ofertë nuk përmban asnjë përcaktim, zbatohet periudha e vlefshmërisë prej 180 ditësh.
- c) Së fundi, një grup i tretë vendesh nuk e rregullon aspak periudhën e vlefshmërisë ose e bën këtë në mënyrë mjaft të kufizuar. Ky grup përfshin Danimarkën, Finlandën, Irlandën, Holandën, Slloveninë, Suedinë dhe Mbretërinë e Bashkuar.

2.7 Përdorimi i sistemit me dy zarfe (Pyetja 20)

Sfondi

Sistemi me dy zarfe, në bazë të të cilit, propozimet teknike dhe financiare paraqiten me zarfe të ndryshme për t'u hapur në kohë të ndryshme, lejon ndarjen e cilësisë dhe çmimit, me qëllim shmangien e vlerësimit të njëanshëm teknik, në rastin kur konsideratat për çmimin mund të jenë paragjyquese ndaj cilësisë. Sigma ka zbuluar gjatë punës se një numër vendesh partnere të saj kanë miratuar ligje për prokurimin publik, të cilat përcaktojnë zbatimin e sistemit me dy zarfe. Është praktikë normale për prokurimin e shërbimeve të konsulencës në projektet e financuara nga Institucionet Financiare Ndërkombëtare (*p.sh.*, Banka Botërore dhe BERZh-i).

Pozicion rregullator në shtetet anëtare

Procedura me dy faza rregullohet vetëm në raste të jashtëzakonshme në shtetet anëtare. Mund të ndodhë që entet kontraktore ta zbatojnë si procedurë në praktikë, por, në këto raste, iu mbetet enteve kontraktore të vendosin për këtë.

Të vetmet vende që kanë përfshirë rregulla për procedurat me dy zarfe janë Bullgaria, Italia dhe Lituania. Bullgaria e ka bërë të detyrueshëm përdorimin e sistemit me dy faza për të gjitha kontratat e lidhura si rezultat in procedurës së tenderimit. Nëse zbatohet kriteri MEAT, oferta e çmimit hapet vetëm pasi është bërë vlerësimi i kriterëve të tjera. Në Itali, kuadri ligjor e bën të detyrueshëm zbatimin e sistemit me dy zarfe, ndërkohë që legjislacioni dytësor përcakton zbatimin e procedurave për kontratat e punëve. Në Lituani, zbatimi i procedurës me dy zarfe është i detyrueshëm për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së dhe kur përdoret kriteri MEAT.

2.8 Rregullat lidhur me konfliktin e interesit (Pyetja 21)

Sfondi

Konflikti i interesit në prokurim mund të ndodhë në mënyra e kapacitete të ndryshme dhe në nivele të ndryshme të procesit. Kjo është një çështje komplekse për t'u trajtuar në kontekstin e prokurimeve. Politika për konfliktin e interesit është hartuar për të garantuar një terren të barabartë loje, bazuar në shanset e drejta dhe të barabarta për të gjithë pjesëmarrësit. Disa situata të konfliktit të interesit mund të përkufizohen lehtësisht. Të tjera janë më pak të dukshme dhe, shpesh, përqendrohen në parimin e përfitimit nga konkurrenca e pandershme, që është shumë më i vështirë për t'u provuar.

Për rrjedhojë, rregullat e prokurimit do të kërkojnë gjithashtu të reduktojnë rastet e konfliktit të mundshëm, duke përfshirë dispozita mbi paanshmërinë dhe fshehtësinë. Në dispozitat që përdoren për të siguruar që nuk do të ketë asnjë rast konflikti i interesit përfshihen:

- ndalimi i pjesëmarrjes në procedurat e përzgjedhjes së kontratës fituese, kur zyrtarët e prokurimeve kanë ndonjë lidhje (familjare, sociale ose financiare) me ndonjë prej ofertuesve;
- kërkesa që këta zyrtarë ta deklarojnë veten të pakualifikueshëm;
- kërkesa që këta zyrtarë të nënshkruajnë deklarata për këtë qëllim;
- ndalimi i pjesëmarrjes së çdo nëpunësi qeveritar në tender, si pjesë e tij (*p.sh.*, si ekspert).

Lidhur me ofertuesit, konflikti i interesit lind kryesisht për shkak të marrëdhënieve dhe lidhjeve që mund t'u japin avantazh të padrejtë ofertuesve të caktuar. Me rëndësi është fakti se, për aq kohë sa ruhet pikënisja e barabartë, si Direktivat, ashtu edhe Marrëveshja Qeveritare për Prokurimet nuk lejojnë përjashtimin e shoqërive mbi baza të përgjithshme. Përjashtimi duhet të vendoset tast pas rasti, në rast se konflikti i interesit ekziston në të vërtetë. Ky këndvështrim u parashtrua edhe nga GjND-ja në çështjen "Fabricom".

Duhet theksuar, gjithashtu, se çështja e konfliktit të interesit nuk është vetëm çështje e legjislacionit të prokurimit, por ajo shpesh rregullohet edhe nga akte të tjera, përfshi ligje të veçanta për konfliktin e interesit. Në disa ligje mbi prokurimin, konflikti i interesit nuk trajtohet më vete, por i përfshirë, për shembull, në organizimin e zhvillimit të tenderit (anëtarësia e komisionit të tenderit).

Pozicioni rregullator në shtetet anëtare të BE-së

Shumë shtete anëtare kanë rregulla për konfliktin e interesit në kuadrin e tyre rregullator të prokurimeve. Për të garantuar paanshmërinë e organizatave, një shumicë vendesh parashikojnë rregulla për trajtimin e situatave që mund të ndodhin brenda enteve kontraktore, si përbërja e komisionit të tenderit dhe marrëdhëniet. Një numër më i vogël e shteteve anëtare kanë rregulla që trajtojnë anën e tenderimit.

Vendet me rregullore për prokurimin, që parashikojnë rregulla të qarta për konfliktin e interesit, janë Bullgaria, Qiproja, Estonia, Hungaria, Italia, Polonia, Rumania, Republika Sllovaqe, Sllovenia dhe Spanja.

Shtetet e tjera anëtare nuk kanë rregulla për konfliktin e interesit në kuadrin e tyre rregullator për prokurimet, por mund t'i kenë këto rregulla të parashikuara në akte të tjera ligjore.

2.9 Rregulla të posaçme për përzgjedhjen e konsulentëve dhe shërbimeve të tjera intelektuale (Pyetja 22)

Sfondi

Sigma, gjatë mbështetjes së saj për përgatitjen e legjislacionit të prokurimit, ka vëzhguar një çështje të përgjithshme lidhur me mënyrën në të cilën duhet të organizohet përzgjedhja e shërbimeve intelektuale dhe të konsulencës. Është diskutuar se ekziston nevoja për përfshirjen e dispozitave të posaçme për prokurimin e këtyre shërbimeve, për shkak të natyrës së veçantë të kontratave, në të cilat cilësia luan, shpesh, një rol më të rëndësishëm sesa çmimi dhe faktorë të tjerë të lidhur me koston. Kur rregullorja e prokurimeve parashikon procedura të posaçme për shërbimet e konsulencës, zakonisht, zbatohet edhe sistemi me dy zarfe (shih 2.7). Koncepti i procedurave të posaçme për shërbimet e konsulencës mund të shihet te Ligji Model i UNCITRAL-it dhe rregullat e prokurimit të Institucioneve Financiare Ndërkombëtare (IFN), si Banka Botërore dhe BERZh-i.

Direktivat e BE-së i parashikojnë të dyja procedurat (e kufizuar ose, kur justifikohet, e negociuar) dhe një metodikë vlerësimi (MEAT), e cila, kur kombinohet, i lejon entet kontraktore ta hartojnë procedurën e prokurimit në një mënyrë të tillë ku nevoja për këto procedura të posaçme mund të duket e kufizuar.

Pozicioni rregullator në shtetet anëtare të BE-së

Mënyra se si e trajtojnë shtetet anëtare këtë çështje konfirmon përfundimin që jemi përpjekur të nxjerrim më sipër. Një shumicë e konsiderueshme vendesh nuk kanë miratuar ndonjë dispozitë të veçantë për përzgjedhjen e fituesit për shërbime intelektuale dhe ua lënë enteve kontraktore të hartojnë procedurat në kuadrin e parashikuar nga Direktivat e BE-së, që zbatohet në legjislacionin kombëtar.

Vetëm tri vende, Austria, Italia dhe Spanja, kanë rregullore prokurimi që përfshijnë rregulla specifike për akordimin e shërbimeve arkitekturore dhe inxhinierike.

2.10 Ndryshimet e planifikuara rregullatore (Pyetja 23)

Në kohën e hartimit, vetëm pak shtete anëtare dukej se kishin planifikuar ndryshime të kuadrin të tyre rregullator, përveç atyre që kërkohen me qëllim përafrimin me legjislacionin e BE-së, si përfshirja në legjislacion e Direktivës së ndryshuar për Zgjidhjet Ligjore.

Austria, Finlanda, Lituania dhe Sllovenia kanë planifikuar ndryshime të kuadrin ligjor jashtë objektit të Direktivës. Suedia, në vitin 2010, do të miratojë një kufi monetar për zbatimin e prokurimit të drejtpërdrejtë në ligj. Holanda synon ta bëjë më miqësor për NMV-të ligjin e saj për prokurimet, duke

përmendur shprehimisht parimet e mosdiskriminimit dhe përpjesëtueshmërisë. Ai do të përfshijë orientim për parimin e përpjesëtueshmërisë me shembuj praktikë.

Për shkak të krizës ekonomike, Austria do të fusë si masë të përkohshme dhe deri në fund të vitit 2010 mundësinë e përzgjedhjes së drejtpërdrejtë të fituesve deri në 100 000 euro për mallrat dhe shërbimet dhe deri në 1 milion për kontratat e punëve. Finlanda ka për qëllim futjen e një sistemi të faturave të shërbimeve për shërbimet II B, grupi 25, me zbatimin e procedurave të posaçme konkurruese. Lituania do të miratojë kritere të reja shpalljeje për portalin e saj qendror në internet, që do të mbulojë planet vjetore të prokurimit, raportet e prokurimit dhe dokumentacionin e tenderit. Së fundi, Sllovenia do të miratojë rregulla të reja botimi për njoftimet e kontratës për mallra dhe shërbime (midis 10 000 eurove dhe 40 000 eurove) dhe për punët (20 000 euro dhe 80 000 euro).

SHTOJCA 1: TABELA PËRMBLEDHËSE

PJESA I: RREGULLAT DHE PROCEDURAT NËN KUFIJTË MONETARË TË BE-SË

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijte monetare	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Austria	BVergG 2006 mbulon sektorët Klasikë dhe të Shërbimeve mbi dhe nën kufijte monetare të BE-së.	< 40 000 euro: blerje e drejtpërdrejtë në sektorin Klasik. < 60 000 euro: blerje e drejtpërdrejtë në sektorin e Shërbimeve. < 120 000 euro (punë) dhe 80 000 euro (furnizime dhe shërbime): procedurë e kufizuar tenderi pa	1. Procedurat e BE-së. 2. Procedura me negociim, me ose pa njoftim paraprak deri në disa kufij të caktuar kombëtarë. 3. Procedurë e kufizuar pa shpallje paraprake të njoftimit. 4. Blerje e drejtpërdrejtë.	Shpallja kërkohet për procedurën e negociuar deri në 350 000 euro (punë) dhe në kufijte monetare të BE-së (furnizimet dhe shërbimet).	Dorëzimi i kërkesave: 14 ditë . Dorëzimi i ofertave: 22 ditë .	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla mbi dhe nën kufijte monetare të BE-së.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
		njoftim (sektorët Klasikë).				

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
Bullgaria	Ligji për Prokurimin Publik mbulon sektorët Klasikë dhe të Shërbimeve (LPP). Vendim qeverie për përzgjedhjen kontratave fituese me vlerë të vogël (OASPC).	Kufijtë monetarë janë të njëjtë si për sektorët Klasikë, ashtu edhe për ato të Shërbimeve. LPP-ja zbatohet me procedurat e BE-së. > 1 075000 euro (punë). > 90 000 euro (furnizime). > 50 000 euro (shërbime). OASPC-ja zbatohet me procedura të thjeshtuara	Procedura e BE-së mbi fashën e parë Konkurrim i hapur dhe procedurë me negociim me ftesë (duhet të jepet arsye justifikuese) brenda fashës së dytë. Mbledhja e ofertave me minimum prej tri	Shpallja në Fletoren Zyrtare dhe në regjistrin kombëtar të prokurimeve mbi fashën e parë të kufijve monetarë kombëtarë. Regjistri i prokurimit publik nën fashën e parë të kufijve monetarë. Kërkesa për	Afatet mbi fashën e parë bazohen në rregullat e BE-së dhe janë nën 33 ditë , të cilat, në raste të caktuara, mund të reduktohen në 22 ditë . Afatet shkurtohen më tej kur përdoren mjetet elektronike	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
	(Vendim për përzgjedhjen e kontratave të prokurimeve me qëllim të posaçëm (mbrojta dhe siguria).	nën kufijtë e lartpërmendur dhe > 100 000 euro (punë). > 25 000 (furnizime dhe shërbime). < 22 000 euro (punë). < 7 500 euro (furnizime dhe shërbime).	ofertash brenda fashës së tretë. Blerje e drejtpërdrejtë nën fashën e fundit.	mbledhjen e ofertave mund të përfshijë shpalljen në media të ndryshme.		

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
Qipro	Ligji për Prokurimin Publik L.12 (I) 2006 për sektorin Klasik mbulon kontratat mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së. Ligji për Prokurimin Publik 11 (I) 2006 për	> 85 000 euro: gjejnë zbatim procedurat e BE-së. < 85 000 euro: gjejnë zbatim procedurat e thjeshtuara. < 1 700 euro:	Përveç procedurave të BE-së, poshtë kufirit monetar kombëtar prej 85 000 eurosh, gjejnë zbatim procedurat e	Mbi kufirin monetar kombëtar, botimi në Fletoren Zyrtare.	Afatet për dorëzimin e ofertave janë 14 ditë dhe 10 ditë për procedurat e hapura dhe 14 ditë për procedurat e kufizuara në poshtë kufijve monetarë të BE-së.	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijte monetare	Metodat	Rregullat e fteses për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
	Shërbimet nuk mbulon kontratat nën kufijte monetare të BE-së. Rregulloret e brendshme për këto kontrata janë të ngjashme me rregullat e parashikuara nga LPP-ja.	përzgjedhje e drejtpërdrejtë.	thjeshtuara konkurruese.		Të njëjtat afate zbatohen për procedurën e thjeshtuar (10 dhe 14 ditë).	
Republika Çeke	Ligji për Prokurimin Publik (137/2006) për sektorët Klasikë dhe të Shërbimeve gjen zbatim për kontratat nën kufijte monetare të BE-së në sektorin Klasik, por jo në sektorin e Shërbimeve. Kontratat e sektorit të Shërbimeve nuk rregullohen nën kufijte monetare të BE-së.	> 70 000 euro për furnizimet dhe shërbimet, procedurat e BE-së me disa thjeshtime > 210 000 euro për kontratat e punëve: procedurat e BE-së me disa thjeshtime. Poshtë këtyre kufijve monetare kombëtarë gjejnë zbatim parimet e Traktatit.	Mbi kufijte-monetarë kombëtarë zbatohen të njëjtat procedura si në Direktivat e BE-së ose një procedurë e thjeshtuar konkurruese me njoftim paraprak (minimalisht, pesë oferta të kërkuara).	Botimi në një portal elektronik qendror për ofertat mbi kufijte monetare kombëtarë. I njëjti format i njoftimit të kontratës si për kontratat sipër kufijve monetare të BE-së. Botim i njoftimeve të kontratave në një faqe të vetën elektronike për procedure e thjeshtuar procedure.	Afatet për dorëzimin e ofertave janë 22 ditë për procedurën e hapur dhe 15 ditë për procedurën e kufizuar. Për këtë të fundit, afati mund të shkurtohet në 7 ditë në rast urgjence. Afati për paraqitjen e kërkesave është 15 ditë ose 10 ditë në rast urgjence.	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijte monetare të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Danimarka	<p>Përzgjedhja e kontratave të punës poshtë kufijve monetarë të BE-së dhe mbi kufirin monetar kombëtar në sektorin klasik qeverisen nga Akti për procedurat e Tenderit për Kontratat e Punëve Publike, Ligji 338, i vitit 2005.</p> <p>Përzgjedhja e kontratave fituese për furnizimet dhe shërbimet sipër kufirit monetar kombëtar në sektorin Klasik rregullohet nga Akti për procedurat e tenderit për Kontratat e Punëve Publike, Ligji 1410/2007.</p> <p>Përzgjedhja e kontratave rregullohet, gjithashtu, nga urdhra qeveritarë</p>	<p>67 000 mallrat, punët dhe shërbimet (autoritetet qeveritare).</p> <p>40 000 euro për punët.</p>	<p>Mund të përdoret çdo procedurë, por autoritetet e qeverisë qendrore kanë detyrimin për të ftuar ofertuesit dhe për të shpallur një njoftim kontrate mbi kufijtë monetarë kombëtarë.</p>	<p>Shpallja e njoftimit të kontratës. Mund të përdoret çdo media.</p>	<p>Kur zbatohet procedura e kufizuar, afati i aplikimit është 15 ditë.</p>	<p>Direktivat e BE-së, por iu lihet autoriteteve kontraktuese të vendosin.</p> <p>Kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së i nënshtrohen së njëjtës procedurë ankesash si ajo për kontratat mbi kufijtë monetarë të BE-së.</p>

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
	dhe ministrorë. Shërbimet përjashtohen. Gjejnë zbatim parimet e Traktatit.					

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Estonia	Akti i Prokurimit Publik /2007 zbatohet për kontrata që janë poshtë kufijve monetarë të BE-së në sektorët Klasikë dhe të Shërbimeve. Gjejnë zbatim parimet e Traktatit të BE-së.	40 000 euro për mallrat dhe shërbimet dhe 250 000 euro për kontratat e punës në sektorët Klasikë, plus kufijve të posaçëm monetarë për raste të veçanta. Poshtë këtyre kufijve gjejnë zbatim parimet e Traktatit. Nuk ka kufij monetarë për Shërbimet. Duhet	Të gjitha procedurat (të hapura, të kufizuara dhe të negociuara) mund të zbatohen lirisht me njoftim paraprak.	Shpallja e njoftimeve në portalin qendror elektronik si për subjektet e sektorit Klasik, ashtu edhe për ato të sektorit të Shërbimeve.	Afati për procedurën e hapur është 22 ditë për kontratat e punëve dhe 15 ditë për mallrat dhe shërbimet. Afati për paraqitjen e kërkesës është 7 ditë .	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
		siguruar konkurrenca efektive.				
Finlanda	Aktet e Prokurimit Publik (348/2007) për kontratat publike dhe (349/2007) për Shërbimet gjejnë zbatim për kontratat sipër dhe poshtë kufijve monetarë të BE-së. Sidoqoftë, përzgjedhja e kontratës fituese në sektorin e Shërbimeve nuk është e rregulluar. Kërkesat e shpalljes përcaktohen në një dekret për të dy sektorët. Gjejnë zbatim detyrimet e përcaktuara në Traktat.	APP-ja për kontratat publike nuk gjen zbatim për: < 15 000 euro për mallrat dhe shërbimet dhe < 100 000 euro për kontratat e punëve. Procedura me negociim me njoftim paraprak mund të përdoret për < 50 000 euro për mallrat dhe shërbimet 500 000 euro për kontratat e punëve.	Procedurat e thjeshtuara të BE-së përdoren mbi kufirin monetar kombëtar. Përzgjedhjet e drejtpërdrejta të kontratave fituese mund të lejohen, në rast se jepen justifikime të ngjashme me ato të parashikuara në Direktivë.	Botimi në portalin qendror elektronik, si edhe në media të tjera.	Nuk ka afate të përcaktuara; duhet lejuar një afat i arsyeshëm për paraqitjen e ofertave.	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij. Sidoqoftë, nuk ka periudhë pauze.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
Franca	Kodi i kontratave publike, Urdhri 649, i vitit 2005, Dekreti 1742 i vitit 2005, Dekreti 1308, i vitit 2005.	<p>< 90 000 euro: modalitetet e shpalljes së njoftimeve të parashikuara nga zyrtari i prokurimeve, në varësi të lëndës së kontratës, sasisë së saj dhe shkallës së konkurrencës.</p> <p>Në kufijtë monetarë midis 90 000 eurosh dhe kufijve monetarë të BE-së: njoftimet botohen në Fletoren Zyrtare ose në gazetën e përcaktuar për njoftime ligjore.</p> <p>> Kufijtë monetarë të BE-së: njoftimet duhet të botohen në Buletin Zyrtar, si edhe në Fletoren</p>	<p>< 4 000 euro: asnjë detyrim.</p> <p>< kufijtë monetarë të BE-së: zyrtari i prokurimeve përcakton lirisht procedurat, në përputhje me nevojat, numrin ose vendndodhjen e operatorëve ekonomikë që ka të ngjarë t'i përmbushin ato.</p> <p>> Kufijtë monetarë të BE-së: procedurat parashikohen nga Direktivat.</p>	<p>< kufijtë monetarë të BE-së: formularët specifikë standardë, modalitetet e botimit përcaktohen nga autoriteti kontraktor (shih "kufijtë monetarë").</p> <p>> Kufijtë monetarë të BE-së: modalitetet parashikohen nga Direktivat.</p>	<p>< kufijtë monetarë të BE-së: afatet përcaktohen nga autoriteti kontraktor (shih "kufijtë monetarë").</p> <p>> kufijtë monetarë të BE-së: afatet e parashikuara nga Direktivat.</p>	<p>< kufijtë monetarë të BE-së: modalitetet përcaktohen nga autoriteti kontraktor (shih "kufijtë monetarë") në përputhje me parimet e Traktatit të BE-së.</p> <p>> kufijtë monetarë të BE-s: rregullat parashikohen nga Direktivat.</p>

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
		Zyrtare të BE-së.				

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Hungaria	Akti CXXIX për Prokurimin Publik.	Sektorët klasikë < 26 700 euro (furnizime dhe shërbime) dhe < 50 000 euro (punë): asnjë detyrim. Shërbimet < 166 700 euro (shërbime dhe furnizime) dhe < 333 300 euro (punë): asnjë detyrim.	< kufijtë monetarë të BE-së: procedura të hapura ose të kufizuara , por autoritetet kontraktore lejohen të negociojnë, në rast se tregojnë qëllimin e tyre në ftesën	Detyrimet për botimin e njoftimit në Buletinin e Prokurimeve Publike. Formatet standarde për kontratat poshtë kufijve monetarë të BE-janë shumë të ngjashme me formatet standarde të	< kufijtë monetarë të BE-së: afati i dorëzimit të ofertave përcaktohet nga autoriteti kontraktor, por ai nuk mund të jetë më pak sesa 25 ditë . Ky afat mund të shkurtohet me 5 ditë , me kusht që specifikimet e tenderit dhe informacioni shtesë të jepen	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
			për ofertë.	BE-së.	elektronikisht.	
Irlanda	Nuk ka rregullime nën kufijtë monetarë të BE-së. Udhëzimet kombëtare për prokurimet publike mund të gjenden në faqen e internetit për prokurimet publike www.etenders.gov.ie	Sipas udhëzimeve kombëtare, rregulli i përgjithshëm është që kontratat > 50 000 euro të shpallen në faqen kombëtare të internetit për prokurimet publike. Procedurat e brendshme të shumë autoriteteve parashikojnë botimin e kontratave me vlerë më të ulët se kjo.	Nuk ka një procedurë të përcaktuar por duhet të përdoren procedura të hapura për kontratat me kufij më të ulët se kufiri monetar i BE-së.	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Italia	Dekreti presidencial 163, i vitit 2006 (“Kodi i kontratave publike”).	<p>Sektorët klasikë < 20 000 euro (furnizimet dhe shërbimet) dhe < EUR 40 000 (punët): lejohej blerja e drejtpërdrejtë.</p> <p>< 500 000 euro (punët): lejohej procedura me negociim pa njoftim.</p> <p>< 750 000 euro (punët): lejohej procedura e thjeshtuar e kufizuar.</p> <p>Shërbimet</p> <p>Entet kontraktore që janë, në të njëjtën kohë, autoritete kontraktore: kufij monetarë të ngjashëm.</p> <p>Shoqëritë publike, si edhe subjektet private që veprojnë në bazë të të drejtave të posaçme ose ekskluzive: rregullat janë</p>	Të njëjtat procedura ndiqen si poshtë ashtu edhe sipër kufijve monetarë të BE-së.	<p>Botimi i njoftimit të kontratës dhe rezultatit të përzgjedhjes së kontratës fituese është i detyrueshëm.</p> <p>Kontratat e punë > 500 000 euro dhe kontratat e furnizimeve e shërbimeve: botimi në Fletoren Zyrtare të vendit dhe në faqen elektronike të Autoritetit Mbikëqyrës të Kontratave Publike.</p> <p>Kontratat e punës < 500 000 euro: shpallja në tabelën e njoftimeve të autoritetit</p>	<p>Procedurë e hapur: 26 ditë (kontratë pune) 15 ditë (furnizim/shërbime).</p> <p>Procedurë e kufizuar ose e negociuar me njoftim: 15 + 20 ditë (kontratë për punë) 7 +10 ditë (furnizime/shërbime).</p>	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
		të parashikuara në rregulloret e tyre.		kontraktor.		

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Letonia	Ligji për Prokurimin Publik për kontratat e sektorit Klasik mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së dhe një Ligj Prokurimesh për sektorin e Shërbimeve, por ky i fundit nuk gjen zbatim poshtë kufijve monetarë të Be-së.	Blerja e drejtpërdrejtë: < 4 200 euro për mallrat dhe shërbimet dhe në 14 000 euro për kontratat e punëve. Procedurë e thjeshtuar: < 30 000 euro për mallra e shërbime dhe 170 000 për punë.	Procedurat e thjeshtuara të BE-së mbi kufirin monetar kombëtar. Procedurat e thjeshtuara kombëtare nën kufirin monetar kombëtar	Rregullat e botimit janë të njëjta me kriteret mbi kufijtë monetarë të BE-së për kontratat mbi kufijtë monetarë kombëtarë. Shpallja e tyre bëhet në portalin qendror elektronik. Nën kufijtë monetarë kombëtarë gjejnë zbatim rregullat e ftesës së thjeshtuar.	Afati për procedurën e hapur është 30 ditë dhe afati për paraqitjen e kërkesave është 25 ditë , në rastin e procedurës së kufizuar dhe të negociuar. Afati për paraqitjen e ofertave është 25 ditë . Afati nën kufirin monetar kombëtar është 15 ditë .	Në thelb, gjejnë zbatim të njëjtat rregulla si për kontratat mbi kufijtë monetarë ashtu edhe për ato poshtë këtij kufiri. Asnjë ankesë nuk mund të paraqitet nën kufijtë monetarë kombëtarë (30 000 dhe 170 000 euro) e as për kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së në sektorin e Shërbimeve.
Lituania	Ligji për Prokurimin Publik rregullon prokurimet publike në sektorët Klasikë dhe të Shërbimeve nën dhe mbi kufijtë monetarë të BE-së. Entet kontraktore në sektorin e Shërbimeve dhe autoritetet kontraktore në sektorin Klasik duhet të	30 000 euro për mallrat dhe shërbimet dhe 145 000 euro për punët. 3 000 euro blerje e drejtpërdrejtë.	Rekomandohen procedurat e thjeshtuara të BE-së mbi kufijtë monetarë kombëtarë. Entet e sektorit Klasik dhe të Shërbimeve do të përcaktojnë procedurat e tyre	Botimi i njoftimit të kontratës në portalin elektronik qendror dhe në fletoren zyrtare. Njoftime kontrate edhe në sektorin e Shërbimeve.	Shtatë ditë nga botimi i njoftimit të kontratës.	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
	përgatitin rregulloret e tyre që duhet të shpallen në portalin qendror elektronik.		nëpërmjet rregulloreve të brendshme.			

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Luksemburgu	Akti i Prokurimit Publik, i vitit 2009.	< 55 000 euro: procedurë e negociuar pa njoftim. < 100 000 euro: procedurë e negociuar pa njoftim, me kusht që të t'iu kërkohet të paktën tre operatorëve ekonomikë të paraqesin një ofertë. > 100 000 euro: procedura e hapur	Procedura e negociuar pa njoftim (shih kufirin monetar). Procedurë e negociuar (shih kufirin monetar) pa njoftim, me kusht që të paktën tre operatorëve ekonomikë t'iu kërkohet të paraqesin një ofertë. Procedurë e hapur (shih kufirin monetar) e detyrueshme, përveçse	Kërkohet botimi i njoftimit në një portal në internet të krijuar nga Ministria e Punëve publike dhe në dy gazeta kombëtare për kontratat > 100 000 euro. Formularë standardë të	Procedura e hapur: 42 ditë . Ky afat mund të shkurtohet në 21 ditë .	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
		është e detyrueshme, përveçse kur Direktivat e BE-së lejojnë procedurën e negociuar me ose pa njoftim. > 800 000 euro: procedura e kufizuar lejohe për kontratat e punëve.	kur procedura e negociuar me ose pa njoftim lejohet nga Direktivat e BE-së. Procedura e kufizuar (shih kufirin monetar) lejohet, gjithashtu, për kontratat e punës.	thjeshtuar për njoftimet nën ku kufijtë monetarë të BE-së. Formularë standardë të ndryshëm për Shërbimet.		

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Holanda	Një Akt Kuadër, instrument ligjor për zbatimin e Direktivave të BE-së. Nuk ka instrument rregullator për	N/A	Praktikohet tenderimi me procedurë të kufizuar me ftesë të drejtpërdrejtë.	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
	kontratat poshtë kufijve monetarë të BE-së. Rregulla udhëzuese (jo të detyrueshme) nxirren si për sektorin Klasik (vetëm kontratat e punëve), ashtu edhe për sektorët e Shërbimeve. Një ligj i ri planifikohet për t'u zbatuar në vitin 2011.		Entet kontraktore përcaktojnë politikën dhe rregullat e tyre për prokurimin konkurrues.			
Polonia	Ligji për Prokurimin Publik (29 janar 2004) rregullon prokurimin në sektorët klasikë mbi kufijtë monetarë të BE-së, si edhe nën kufijtë monetarë të BE-së për kontratat në sektorin Klasik.	LPP-ja nuk gjen zbatim për kontratat nën 14 000 euro.	Procedurat e thjeshtuara të BE-së gjejnë zbatim nën kufijtë monetarë të BE-së.	Njoftimi i kontratës dhe i përzgjedhjes së fituesit duhet të botohen në portalin elektronik qendror të prokurimeve.	Kërkesat: 7 ditë . Procedura e hapur: 20 ditë për kontratat e punëve dhe 7 ditë për mallrat dhe shërbimet. Procedura e kufizuar: 14 ditë për kontratat e punëve dhe 7 ditë për mallrat dhe shërbimet. Dialogu konkurrues dhe procedura e negociuar 10 ditë .	Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së. Mund të paraqiten ankesa për çdo lloj kontrate, në bazë të LPP-së (jo për sektorin e Shërbimeve nën kufijtë monetarë të BE-së). Sidoqoftë, nën kufijtë monetarë të BE-së për paraqitjen e ankimeve, sa i përket natyrës së ankesës.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Rumania	<p>Ligji për Prokurimin Publik, miratuar me Urdhër Emergjent Qeveritar nr. 34, i vitit 2006 dhe Ligji 337, i vitit 2006, si edhe aktet ligjore miratuar me Vendim Qeverie 925, të vitit 2006.</p> <p>LPP-ja mbulon kontratat në sektorët Klasikë dhe të Shërbimeve që janë mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së. Duhet respektuar parimet e Traktatit të BE-së.</p>	<p>< 15 000 euro: blerje e drejtpërdrejtë.</p> <p>< 100 000 euro për kontratat e shërbimeve dhe furnizimeve dhe 750 000 euro për kontratat e punëve: procedura të thjeshtuara.</p> <p>Mbi kufijtë monetarë për procedurën e thjeshtuar, gjejnë zbatim procedurat e BE-së, përveçse në rastet e afateve dhe botimit në Fletoren Zyrtare.</p>	<p>Procedurë e thjeshtuar me kërkesë për ofertë nën kufijtë monetarë kombëtarë.</p> <p>Në të kundërt, zbatohen në thelb procedurat e parashikuara në Direktivat e BE-së.</p> <p>Të njëjtat rregulla vlejné edhe për Shërbimet.</p>	<p>Botimi i njoftimeve të kontratës dhe të përzgjedhjes së kontratës fituese në portalin qendror elektronik (ESPP) në formë të thjeshtuar.</p> <p>Mbi kufijtë monetarë kombëtarë përdoren formularët e njoftimit të BE-së.</p>	<p>Afati për dorëzimin e ofertave për procedurën e thjeshtuar është 10 ditë, që mund të reduktohet në 6 ditë, kur dorëzimi bëhet në mënyrë elektronike.</p> <p>Mbi kufijtë monetarë kombëtarë, afati për procedurën e hapur është 20 ditë (15 ditë në formë elektronike). Për procedurën e kufizuar, afati i paraqitjes së kërkesës është 10 ditë dhe ai i ofertave 15 ditë, që mund të shkurtohet në rastin e dorëzimit në rrugë elektronike. Procedura</p>	<p>Në thelb, zbatohen të njëjtat rregulla, si mbi kufijtë monetarë të BE-së, ashtu edhe nën këta kufij.</p> <p>Periudha pezull është 6 ditë nën kufijtë monetarë të BE-së, ndërsa mbi këta kufij është 11 ditë.</p>

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
					konkurruese 20 ditë dhe procedura e negociuar 10 ditë .	

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specififikimet teknike dhe ankesat)
Republika Sllovaqe	Akti i Prokurimit Publik nr. 25, i vitit 2006, i ndryshuar me aktet 232 dhe 442, të vitit 2008, qeveris kontratat poshtë kufijve monetarë të BE-së në sektorin Klasik. Sektori i Shërbimeve është i parregulluar. Shërbimet e II B	65 000 euro për mallrat dhe shërbimet dhe 360 000 euro për kontratat e punëve. 30 000 euro për mallrat dhe shërbimet dhe 120 000 euro për kontratat e punëve. Poshtë kufirit të	Mbi fashën e parë të BE-së zbatohen procedurat me afate të shkurtuara. Midis fashës së lartë dhe asaj të ulët zbatohen procedurat e thjeshtuara. Blerja e drejtpërdrejtë lejohet nën fashën më të ulët.	Mbi fashën e parë, botimi i njoftimeve të kontratës dhe përzgjedhjes së fituesit është i njëjtë me ato që bëhen mbi kufijtë monetarë të BE-së dhe duhet të jetë në buletin elektronik të prokurimit publik, që administrohet nga OPP-ja (e detyrueshme). Nxitet	Fasha e parë: procedura e hapur për paraqitjen e ofertave është 36 ditë dhe procedura e negociuar 22 ditë . Midis fashës së lartë dhe asaj të ulët, autoritetet kontraktore mund të përcaktojnë afate	Në thelb, të njëjtat rregulla zbatohen mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së. Sidoqoftë, nuk mund të paraqiten ankime për kontrata poshtë fashës së dytë.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijte monetare	Metodat	Rregullat e fteses për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
	rregullohen nga dispozita që gjejnë zbatim për kontratat nën kufijte monetare të BE-së.	lartpërmendur monetar janë kontratat me vlerë të ulët.		botimi në media të tjera. Për procedurën e thjeshtuar mund të përdoret buletini elektronik dhe media të tjera.	e arsyeshme.	

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijte monetare	Metodat	Rregullat e fteses për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Slovenia	Akti i Prokurimit Publik (ZJN-2) për kontratat e sektorit Klasik dhe Akti i Prokurimit Publik (ZJNVETPS) për kontratat e sektorit të Shërbimeve. Zbatohen dispozitat	40 000 euro për mallrat dhe shërbimet dhe 80 000 euro për punët. 10 000 euro për shërbimet dhe mallrat dhe 20 000	Procedurat e BE-së mund të zbatohen poshtë kufirit monetar të BE-së ose në procedurën e thjeshtuar (një ose dy faza) me shpallje paraprake të njoftimit.	Botimi në portalin qendror elektronik i të gjitha kontratave, për të cilat botimi është i detyrueshëm. Mbi fashën e parë, njoftimet e	Nëse procedurat e BE-së përdoren nën kufijte monetare të BE-së, afatet duhet të jenë të njëjta. Në të kundërt, autoritetet kontraktore kanë	Në thelb, të njëjtat rregulla zbatohen mbi dhe nën kufijte monetare të BE-së.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
	<p>e Traktatit të BE-së. Të dyja aktet rregullojnë kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së. Përzgjedhja e fituesit për shërbimet II B mbulohet nga APP-ja dhe duhet të zbatohet me shpalljen e njoftimit të kontratës.</p>	<p>euro për punët. Poshtë kësaj fashe që është më e ulëta zbatohet prokurimi me vlerë të vogël.</p>	<p>Në fashën e dytë të kufijve monetarë është e mundur të zbatohet procedura e thjeshtuar me ftesë të drejtpërdrejtë (minimum tre oferta).</p> <p>Poshtë fashës së ulët lejohet blerja e drejtpërdrejtë.</p> <p>Këta kufij monetarë dhe këto metoda zbatohen edhe në sektorin e Shërbimeve.</p>	<p>kontratës dhe të përzgjedhjes së fituesit duhet të jenë sipas kërkesave të BE-së, por të thjeshtuara.</p>	<p>të drejtën të përcaktojnë afatet për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave, në varësi të kompleksitetit dhe natyrës së kontratave.</p>	

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Spanja	Ligji 30, i vitit 2007 (kontratat e sektorit publik) Ligji 31, i vitit 2007 (Shërbimet). Dekreti Mbretëror 1098, i vitit 2001. Dekreti Mbretëror 817, i vitit 2009.			Njoftimet specifike standard për kontrata nën kufijtë ligjorë të BE-së. Nuk ka rregullim për kontratat e posaçme sektoriale nën kufijtë monetarë të përcaktuar nga Direktiva 2004/18.	Për kontratat e sektorit publik nën kufijtë monetarë të BE-së, të paktën 15 ditë për dorëzimin e ofertave (procedurë e hapur ose e kufizuar).	Në thelb, të njëjtat rregulla zbatohen mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së.
Suedia	Ligji –për Prokurimin Publik (LOU) për sektorin Klasik dhe Ligji për Prokurimin Publik (LUF) për sektorin e Shërbimeve/ Shërbimet. Këto akte mbulojnë kontratat nën kufijtë	Nuk ka kufij monetarë kombëtarë. Blerja e drejtpërdrejtë lejohet për kontrata me vlerë të ulët dhe i takon autoritetit kontraktorë ta	Përdoret procedura e thjeshtuar e hapur ose e kufizuar me njoftim paraprak.	Botimi i detyrueshëm i njoftimeve të kontratës në baza të gjithpranuara të dhënash (operatorë private të akredituar).	Afati për kërkesat duhet të jetë minimumi 10 ditë dhe për dorëzimin e ofertave duhet të jetë një afat i arsyeshëm i caktuar nga autoriteti kontraktor.	Në thelb, të njëjtat rregulla zbatohen mbi dhe nën kufijtë monetarë të BE-së.

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijte monetare	Metodat	Rregullat e fteses për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
	monetarë të BE-së. Respektohen detyrimet e Traktatit të BE-së. Shërbimet II B mbulohen nga regjimi thjeshtuar i LOU-t dhe LUF-së.	vendosë këtë (zbatohet njësoj, si në sektorin Klasik, ashtu edhe në sektorin e Shërbimeve).				

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijte monetare	Metodat	Rregullat e fteses për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
Mbretëria e Bashkuar	Rregullorja për Rregulloret për Kontratat Publike S1 2006/5 dhe Kontratat S1 2006/6 zbatojnë Direktivat e BE-së mbi kufijte monetare të BE-së. Nuk ka instrumente	Nuk ka	Si udhëzim, kërkesat e “vlerës në raport me çmimin” nënkuptojnë përdorimin e procedurave të hapura	Nuk ka	Nuk ka	Nuk ka

Shteti anëtar	Instrumenti rregullator	Kufijtë monetarë	Metodat	Rregullat e ftesës për ofertë	Afatet	Rregulla të tjera (Kriteret e kualifikimit, kriteret e përzgjedhjes së fituesit, specifikimet teknike dhe ankesat)
	rregullatore nën kufijve monetarë të BE-së. Respektohen detyrimet e Traktatit të BE-së.		konkurruese.			

SHTOJCA 2: PYETËSORI

SONDAZHI I SIGMA-S: SI E RREGULLOJNË SHTETET ANËTARE PROKURIMIN PUBLIK JASHTË OBJEKTIT TË DIREKTIVAVE

Pjesa I. Rregullat dhe procedurat me rendësi të posaçme për prokurimin nën kufijtë monetarë të BE-së

Pyetje 1. *Instrument(et) rregullatore ose udhëzimet për përzgjedhjen e kontratës fituese nën kufijtë monetarë të BE-së*

- Së pari, me qëllim që të jemi të plotë, ju lutemi, përmendni instrument(et) për përzgjedhjen e kontratës që mbulohen nga Direktivat e BE-së 17 dhe 18, të vitit 2004 (mbi kufijtë monetarë të BE-së).
- Parashikohet nga instrumenti rregullator se, në përzgjedhjen e një kontrate fituese nën kufijtë monetarë të BE-së, duhen zbatuar detyrimet e Traktatit të BE-së?
- Përdoret i njëjti instrument rregullator për kontratat nën kufijtë monetarë të BE-së? Nëse jo, ju lutemi, përmendni instrument(et) rregullatore për përzgjedhjen e kontratave nën kufijtë monetarë të BE-së (p.sh., legjislacioni për prokurimin publik, rregulloret e veçanta ose akte të tjera administrative).
- Përdoret i njëjti instrument rregullator për kontratat në kufijtë monetarë të BE-së qoftë në sektorin Klasik ashtu edhe në atë të Shërbimeve?
- Ka instrumente rregullatore për Shërbimet II B nën kufijtë monetarë të BE-së? Ju lutemi, përmendni dhe renditni karakteristikat kryesore të procedurave të përzgjedhjes së fituesit për këtë kategori shërbimesh.
- Nëse përzgjedhja e kontratave fituese nën kufirin monetar rregullohet kryesisht apo vetëm nëpërmjet udhëzimeve të nxjerra nga qeveria (p.sh., Mbretëria e Bashkuar), në vend të instrumenteve rregullatore, ju lutemi, jepni hollësi se ku mund të gjenden këto udhëzime. (Nëse është kështu, ju lutem vendosni 'nuk ka' për pyetjet vijuese lidhur me instrumentet rregullatore, kur është e nevojshme).

Pyetje 2. *Kufijtë monetarë kombëtarë përveç kufijve monetarë të BE-së*

- Përveç kufijve monetarë, të cilët nxisin zbatimin e rregullave të BE-së, përdorni ndonjë kufi monetar kombëtar? Ju lutemi, përmendni konkretisht rolin e këtyre kufijve monetarë (p.sh., përdorimin e procedurave të thjeshtuara, blerjes së drejtpërdrejtë, ftesa për kuotim). Janë këta kufij kombëtarë të njëjti si në sektorët Klasik ashtu edhe në ato të Shërbimeve?

Pyetje 3. *Procedurat e prokurimit nën kufijtë monetarë të BE-së*

- Ju lutemi, përmendni procedurat e prokurimit (p.sh., tenderimi i kufizuar, ftesa për kuotim, blerja e drejtpërdrejtë dhe procedura të tjera të thjeshtuara) të cilat lejohen nën kufijve monetarë të BE-së dhe cilat janë kushtet apo kufijtë monetarë për përdorimin e tyre?

- Janë ato të njëjta si për sektorin publik, ashtu edhe atë të Shërbimeve?

Pyetje 4. *Rregullat për ftesën për ofertë nën kufijtë monetarë të BE-së*

- Cilat janë rregullat për ftesën për ofertë nën kufijtë monetarë të BE-së, sa u përket kritereve të botimit apo mundësisë për të bërë një ftesë të drejtpërdrejtë për ofertë, pa njoftim paraprak?
- Në rastin e kritereve të publikimit, cila media do të përdoret?
- Sa më sipër, ka ndryshime midis sektorit publik dhe Shërbimeve?

Pyetje 5. *Rregullat e botimit*

- Në rastin e tenderave të hapur, cilat njoftime kërkohen (p.sh., njoftim paraprak, njoftim për tender, njoftim për përzgjedhjen e fituesit)?
- Janë këto të njëjta për sektorin publik dhe të Shërbimeve?

Pyetje 6. *Afatet e dorëzimit të kërkesave dhe ofertave*

- Ju lutemi, përmendni afatet për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave, sipas procedurave të renditura në pyetjen 3 (Procedurat e prokurimit) më sipër.

Kërkesa=

Oferta=

Pyetje 7. *Mjetet për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave*

- Ka rregulla për dorëzimin e kërkesave dhe ofertave (p.sh., nëpërmjet postës apo në rrugë elektronike)? Nëse po, ju lutem përmendini konkretisht.

Pyetje 8. *Politikat dhe rregullat për përzgjedhjen sasiore*

- Ka politika, rregulla ose procedura për përcaktimin e kualifikimeve të ofertuesit për zbatimin e një kontrate? Nëse ato janë të ndryshme nga rregullat mbi kufijtë monetarë të BE-së, ju lutem përmendini.

Pyetje 9. *Politikat dhe rregullat për vlerësimin e ofertës dhe kriteret e përzgjedhjes së fituesit*

- Ka politika, rregulla ose procedura për vlerësimin e ofertës dhe zbatimin e kritereve të përzgjedhjes së fituesit? Janë ato të ndryshme nga rregullat mbi kufijtë monetarë të BE-së, ju lutemi, përmendini.
- Ka rregulla për përcaktimin e ofertave me vlerë nën kufirin më të ulët?

Pyetje 10. *Rregullat për specifikimet teknike*

- Ka rregulla për përkufizimin e specifikimeve teknike? Nëse janë të ndryshme nga rregullat mbi kufijtë monetarë të BE-së, ju lutemi, përmendini.

Pyetje 11. *Politikat dhe rregullat për prokurimin elektronik*

- Ka politika apo rregulla për kryerjen e prokurimit elektronik? Nëse janë të ndryshme nga rregullat mbi kufijtë monetarë të BE-së, ju lutemi, përmendini.

Pyetje 12. *Politikat dhe rregullat për marrëveshjet kuadër*

- Ka politika apo rregulla për përzgjedhjen e marrëveshjeve kuadër? Nëse janë të ndryshme nga rregullat mbi kufijtë monetarë të BE-së, ju lutemi, përmendini.

Pyetje 13. *Procedurat ekzistuese për ankesat, rishikimet dhe zgjidhjet ligjore*

- Cilat janë procedurat në fuqi për ankesat, rishikimet dhe zgjidhjet ligjore? Nëse janë të ndryshme nga rregullat mbi kufijtë monetarë të BE-së, ju lutemi, përmendini. Ju lutemi, përmendni organet kompetente që merren me shqyrtimin e ankimeve. Janë këto të njëjtat organe që merren me procedurat mbi kufijtë monetarë të BE-së?

Pjesa II. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme që nuk trajtohen nga Direktivat e BE-së (por që përfshihen shpesh në regjimet e prokurimit të shteteve anëtare të BE-së)

Pyetje 14. Organizimi i zhvillimit të tenderit

- Janë të detyruara autoritetet kontraktore të krijojnë Komisione të përkohshme Tenderi për administrimin e procesit të tenderimit? Nëse përgjigjja është po, cilat janë funksionet kryesore dhe mandati i komisioneve të tenderit? Rregullohet me ligj apo akte nënligjore përbërja dhe përgjegjësitë e këtyre komisioneve?
- Cili individ/autoritet është i autorizuar të marrë vendimin për përzgjedhjen e fituesit për llogari të Autoritetit Kontraktor? Është kjo e rregulluar me ligj apo akte nënligjore?

Pyetje 15. Kualifikimi dhe dokumentacioni i tenderit

- A parashikon instrumenti rregullator në fuqi përmbajtjen e hollësishme të ndonjë dokumentacioni të veçantë parakualifikimi/përzgjedhjeje? Nëse përgjigjja është po, ju lutemi, përmendni konkretisht rregullat kryesore.
- Përcakton instrumenti rregullator përdorimin e dokumentacionit standard ose model për prokurimin e mallrave, punëve dhe shërbimeve? Nëse përgjigjja është po, ju lutemi përmendni rregullat kryesore apo përmendni seksionet përkatëse të instrumentit rregullator në fuqi.
- Në vijim të një ftese për tender, a duhet që ofertuesi të paguajë *një tarifë* për dokumentacionin e tenderit? Nëse përgjigjja është po, ju lutemi përmendni rregullat.

Pyetje 16. Hapja e ofertave

- Cilat janë rregullat për hapjen e ofertave? A duhet të hapen *publikisht* ofertat? Nëse po, kush mund të jetë i pranishëm në hapjen e tyre apo duhet të zhvillohet një seancë me dyer të mbyllura?
- Ka dallime në procedurat e hapjes, sa i përket procedurës së përdorur dhe vlerës ose natyrës së kontratës (mallra/shërbime/punë)?

Pyetje 17. Sigurimi i ofertës dhe zbatimit të kontratës

- Lejon instrumenti rregullator që autoriteti/enti kontraktor të kërkojë që dorëzimi i një oferte të shoqërohet me si *sigurimin e ofertës*? Nëse përgjigjja është po, cilat janë rregullat dhe cila është shuma?
- A lejon instrumenti rregullator që autoriteti/enti rregullator që autoriteti/enti kontraktor të kërkojë që lidhja e një kontrate me një ofertues të shoqërohet me *sigurimin e zbatimit të kontratës*? Nëse përgjigjja është po, cilat janë rregullat dhe shuma?

Pyetje 18. Anulimi i zhvillimit të tenderit

- Parashikohet nga instrumenti rregullator anulimi i zhvillimit të tenderit? Nëse po, ju lutemi përmendni rregullat?

Pyetje 19. *Afati i vlefshmërisë së tenderit*

- Parashikon instrumenti rregullator ndonjë afat për vlefshmërinë e tenderit, përfshi shtyrje të mundshme të afatit të vlefshmërisë së tenderit? Nëse po, ju lutemi përmendni rregullat.

Pyetje 20. *Përdorimi i sistemit me dy zarfe?*

- E parashikon instrumenti rregullator përdorimin e sistemit me dy zarfe (dorëzimi i ofertës teknike dhe financiare në zarfe të ndryshme)? Nëse po, ju lutemi, përmendni rregullat.

Pyetje 21. *Konflikti i interesave*

- A përcakton regjimi rregullator ndonjë rregull që gjen zbatim në fushën e prokurimit publik për çështjen e konfliktit të interesave? Nëse po, ju lutemi, përmendni rregullat.

Pyetje 22. *Rregulla të posaçme për përzgjedhjen e konsulentëve ose shërbimeve të tjera intelektuale*

- Parashikon instrumenti rregullator ndonjë rregull dhe procedurë konkrete për përzgjedhjen e shërbimeve të konsulencës/intelektuale? Nëse po, përmendni rregullat.

Pyetje 23. *Ndryshimet ose nismat e planifikuara për rregullimin e prokurimit publik jashtë fushës së zbatimit të Direktivave të BE-së (Pjesa I dhe II e pyetësorit)*

Përveç përafrimit ligjor me legjislacionin e BE-së dhe nismat kombëtare për ligjin për koncesionet/PPP, a parashikoni ndonjë ndryshim në kuadrin rregullator jashtë fushës së veprimit të Direktivës së BE-së? Nëse po, ju lutemi, përmendini.